

RAPORT PARAPRAK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS

Hartuar sipas: VKM Nr. 686, datë: 29.07.2015, "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësiave e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore" i ndryshuar, Ligjit Nr. 10 440, datë: 07.07.2011, "Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis", Shtojca II, pika 10. gj) Veprat bregdetare kundër erozionit dhe punimet në det që mund të ndryshojnë bregun për shkak të ndërtimeve, për shembull, të digave, moleve, bankinave të ankorimit dhe punimeve të tjera për mbrojtje nga deti, duke përfshirë mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla.

RAPORT PARAPRAK I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS **"SISTEMIMI DHE MBROJTJA E ARGJINATURES VERIORE TE LAGUNES SE KARAVASTASE PREJ** **EROZIONIT", FAZA I**

Adresa: Divjake, Karavasta



Tirane 2024

PËRMBAJTJA

➤ **Hyrje** 3

1. INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR 3

a) *Pershkrim te qellimit dhe objektive te VNM-se* 3

b) *Kuadri Ligjor Mjedisor dhe Institucional* 5

c) *Kuadri Ligjor nderkombetar* 6

2. PERSHKRIMI I PROJEKTIT 7

a) *Pershkrimi i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar edhe me fotografi;* 9

b) *Informacion per pranine e burimeve ujore, ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij;* 17

c) *Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme, negative, ne mjedis, te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer;* 19

ç) *nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis, te tilla si: ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe per prodhimin e mbetjeve;* 21

d) *Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara;* 25

dh) *te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te;* 28

e) *mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme, si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin;* 29

ë) *masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis;* 31

f) *ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille);* 34

3. PERFUNDIME 35

➤ **HYRJE**

Ky Vlerësim Paraprak i Ndikimit në Mjedis është i përgatitur për projektin **“Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit”, Faza I**” dhe është pjesë e dokumentacionit të nevojshëm të kërkuar për këtë projekt.

Studimi i Vleresimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) siguron një përmbledhje të të dhënave ekzistuese dhe informacion mbi kushtet e sheshit të zhvillimit të aktivitetit duke përfshirë kushtet fizike atmosferike dhe të burimeve ujore dhe biologjike, burimet kulturore dhe gjendjen social-ekonomike të zones. Në procesin studimor të VNM përdoren informacioni dhe të dhënat ekzistuese dhe të perfituara rishtas mbi kushtet e sheshit, se bashku me standardet dhe normat e zbatueshme për të vlerësuar impaktet potenciale mjedisore dhe sociale të fasiliteve të propozuara.

Ky raport hartohet mbi bazën e mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim - marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme.

VNM është një proces sistematik për të përcaktuar dhe vlerësuar efektet apo ndikimet në mjedis të një veprimi apo projekti të caktuar. Në një situatë normale, ky proces aplikohet përpara se të merren vendimet dhe të fillojnë angazhimet për realizimin e projektit. Por sidoqoftë, dhe në çdo kohë, efektet sociale, kulturore dhe shëndetësore janë konsideruar si pjesë integrale e VNM-së.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit.

Projekti në studim është objekt i ligjit nr. 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar, Shtojca II, pika 10. gj) Veprat bregdetare kundër erozionit dhe punimet në det që mund të ndryshojnë bregun për shkak të ndërtimeve, për shembull, të digave, moleve, bankinave të ankorimit dhe punimeve të tjera për mbrojtje nga deti, duke përjashtuar mirëmbajtjen dhe rindërtimin e veprave të tilla.

➤ INFORMACION PER QELLIMIN E VNM-se DHE METODIKEN E ZBATUAR

VNM gjithashtu përfshin parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet:

1. Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit që në fazën e përgatitjes së propozimeve në projekt.
2. Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit
3. Të japë një gjendje sa më reale nga pikëpamja e ndikimit dhe impaktit në mjedis nga aktiviteti që do zhvillohet.
4. Analizimin e faktorëve pozitivë dhe negativë mjedisorë, marrjen e masave zbutëse, reduktuese dhe eliminuese për ndikimet negative.
5. Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
6. Propozime dhe rekomandime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Objektivat afatshkurter te VNM jane:

1. Përmirësim nga pikëpamja mjedisore të projektit të propozuar;
2. Të hartojë plane për menaxhimin e mjedisit dhe aksidenteve në vendin e punës;
3. Të hartojë planin për monitorimin e mjedisit për të mbajtur nën kontroll ndikimet;
4. Të informojë institucionet vendore, komunitetin dhe grupet e tjera të interesit për zhvillimin e projektit;
5. Të nxjerrë konkluzione dhe rekomandime mbi rëndësinë e projektit në lidhje me ndikimet negative dhe pozitive si dhe rëndësinë sociale të tij.
6. Objektivat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përfshijnë përcaktimin, përshkrimin dhe vlerësimin e ndikimeve të pritshme të drejtpërdrejta e jo të drejtpërdrejt mjedisore gjatë zbatimit apo mos zbatimit të projektit.
7. Të minimizojë ndikimet e drejtpërdrejta në mjedis dhe në radhë të parë në elementet prioritarë si ruajtja e tokës, kontrolli i zhurmave, dhe ruajtja e cilësisë së ujit dhe ajrit.
8. Të ruajë ose rehabilitojë mjedisin natyror përmes elementeve të reja të ndërhyrjes pozitive, punimeve të veçanta në kuadër të projektit ose paralel me të, të cilët sigurojnë vijueshmërinë e qëndrueshme të mjedisit biologjik duke përfshirë faunën dhe florën në mjediset përreth zonës së marrë në konsideratë.
9. Të japë informacion mbi vendndodhjen e impiantit dhe të analizojë tiparet mjedisore
10. Siguron që burimet natyrore janë përdorur në mënyrë të duhur dhe me efikasitet;
11. Siguron që është përzgjedhur alternativa më e mirë e vendodhjes së projektit.
12. Siguron që janë marrë në konsideratë teknikat më të mira të disponueshme të teknologjisë së propozuar për tu aplikuar.

Objektivat afatgjate te VNM jane:

- ❖ Siguron dhe mbron shendetin e njeriut;
- ❖ Parashikon dhe parandalon ndryshimet/demtimet e pakthyeshme te mjedisit;
- ❖ Permireson aspektet sociale-ekonomike te projektit;
- ❖ Ndhmon ne realizimin e parimit te zhvillimit te qendrueshem te mjedisit;

Pershkrim i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtme:

- ❖ Njohja dhe studimi i projektit, teknologjia e tij;
- ❖ Njohja me infrastrukturën ekzistuese të objektit ku kruhet aktiviteti;
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis;
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes;
- ❖ Historiku i ndërveprimit mjedisor;

KUADRI LIGJOR MJEDISOR DHE INSTITUCIONAL

Menaxhimi dhe mbrojtja e mjedisit janë pjesë e Legjislacionit Shqiptar, Neni 59(d) shkruhet se: “Shteti, brënda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësimin e nismës dhe të përgjegjësisë private, synon: Neni d): një mjedis të shëndetshëm dhe ekologjikisht të përshtatshëm për brezat e sotëm dhe të ardhshëm. Sipas Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është autoriteti përgjegjës për rishikimin e dokumentit të VNM-së të përgatitur nga ekspertet e licensuar prej saj. Përveç Ligjit Nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, Parlamenti i Republikës së Shqipërisë miratori edhe Ligjin Nr. 10440 Datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”. Ky ligj është zhvilluar dhe bazuar në Direktivat e EU dhe praktikat ndërkombëtare të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Nder ligjet e tjera të legjislacionit kombëtar në lidhje me VNM-në dhe mjedisin përfshijnë:

1. Ligji nr. 10431, date 09.06.2011 ‘Per mbrojtjen e mjedisit’, te ndryshuar;
2. Ligji nr. 10440, date 07.07.2011 ‘Per vleresimin e ndikimit ne mjedis’, te ndryshuar;
3. Ligji nr.10006, date 23.10.2008 “Per mbrojtjen e faunes se eger”
4. Ligji nr. 8906, date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura” ndryshuar me ligjin, Nr.9868, date 4.2.2008 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr.8906 date 6.6.2002 “Per zonat e mbrojtura”
5. Ligi nr.10 253, date 11.3.2010 “Per gjuetine”
6. Ligji Nr. 9533, date 15.5.2006 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
7. Ligji Nr. 9791, date 23.7.2007 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
8. Ligji Nr. 15/2012, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"

VNM- PARAPRAKE

9. Ligji Nr. 36/2013, Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
10. Ligji Nr. 38/2013 Per disa ndryshime ne Ligjin Nr. 9693, date 19.03.2007 "Per fondin kullisor te ndryshuar"
11. Ligji Nr. 9385, date 4.5.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor"
12. Ligji nr. 68/2014 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9587, date 20.7.2006, “Per mbrojtjen e biodiversitetit”, te ndryshuar.
13. Ligji nr. 162/2014 "Per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
14. VKM nr. 686, date 29.07.2015 ‘Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve perzhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis(VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit dhe deklarates mjedisore’;
15. VKM nr. 247, date 30.04.2014 “Per percaktimin e rregullave, te kerkesave e te procedurave per informimin dhe perfshirjen e publikut ne vendimmarrjen mjedisore”
16. Ligji nr. 10 463, date 22.9. 2011”Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”, te ndryshuar;
17. VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
18. VKM nr.175, date 19.1.2011 “Per miratimin e strategjise kombetare te menaxhimit te mbetjeve dhe te planit kombetar te menaxhimit te mbetjeve”
19. VKM nr. 371, date 11.06.2014 “Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
20. VKM nr. 418, date 25.06.2014 “Per grumbullimin e diferencuar te mbetjeve neburim”
21. VKM nr. 229, date 23. 04. 2014 “Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”
22. VKM nr.519, date 30.6.2010 “Parqet Natyror Rajonal”
23. Vendim Nr. 22, date 9.1.2008 "Per caktimin e procedurave dhe te kriterëve te administrimit te pyllit komunal"
24. Vendim Nr. 1354, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe procedurat qe ndiqen per heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit te fondit kullisor"
25. Vendim Nr. 396, date 21.06.2006 "Per kriteret e transferimit dhe te perdorimit te pyjeve nga njesite e qeverisjes vendore"
26. VKM nr.897. date 21.2.2011 “Miratimi i Rregullave per Shpalljen e Zonave te Vecanta te Ruajtjes”
27. VKM nr. 532, date 05.10.2000 “Per miratimin e studimit “Strategjia dhe Plani i veprimit per biodiversitetin”
28. VKM nr. 676, date 20.12.2002 “Per shpalljen zone e mbrojtur te monumenteve te natyres shqiptare”
29. VKM nr. 594, date 10.09.2014 "Per miratimin e Strategjise Kombetare per cilesine e ajrit te mjedisit"
30. Vendimi Nr. 435, date 12.9.2002 “Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise”
31. VKM nr 352, date 29.04.2015. “Per vleresimin e cilesise se ajrit te mjedisit dhe kerkesat per disa ndotes ne lidhje me te”.
32. Udhezimi i përbashkët Nr.2 datë 15.11.2023 për “Nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore”

KUADRI LIGJOR NDËRKOMBETAR

Raporti i VNM-se për projektin në fjalë, merr në konsideratë dhe mundohet të përqsë pjesë të tij me legjislacionin e BE mbi probleme mjedisore dhe jo vetëm. Direktivat me kryesore :

- ✚ Direktiva e KE 1999/30/CE 22 Prill 199, për vlerat kufi për dioksidin e squfurit, dioksidin e azotoit dhe oksidin e azotit, PM dhe plumbit.
- ✚ Direktiva 2000/60/CE e Parlamentit dhe e Këshillit të Europës, Kuadri ligjor për veprimet e komunitetit ne fushën e politikës së ujrave.
- ✚ Direktivës KE 42/2001 (të Këshillit të Evropës), mbi VNMS dhe VSM.
- ✚ Direktiva 2008/50, CE, e Parlamentit dhe e Këshillit të Evropës (21 Maj 2008) ”Mbi cilësinë e ajrit në mjedis, për një ajër më të pastër për Evropën”.
- ✚ Direktiva 75/442/CEE e Këshillit e datës 14 Korrik 1975, Mbi Mbetjet.
- ✚ Direktiva 91/689/CEE e Këshillit e datës 12 Dhjetor 1991, Mbi Mbetjet e Rrezikshme.
- ✚ Direktiva 2001/42/CE e Këshillit dhe e parlamentit Evropian e datës 27 qershor 2001, Mbi vlerësimin e Pasojave te Planeve dhe Programeve te Caktuara mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva 85/337/CEE e Këshillit e datës 27 Qershor 1985, Mbi Vlerësimin e Pasojave të Disa Projekteve Publike dhe Private mbi Mjedisin.
- ✚ Direktiva e Këshillit 96/62/EC Mbi vlerësimin dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit në mjedis.
- ✚ Direktiva 1999/30/CE, Në lidhje me vlerat kufi për NO₂, NO_x, SO₂, lëndët grimcore dhe Pbnë ajër.
- ✚ Direktiva e Komisionit Evropian CEE/CEEA/CE 78/659 per cilesine e ujerave te embla
- ✚ Direktiva 99/61/CE Për gropat e mbetjeve.

➤ PERSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti **“Sistemimi dhe mbrojtja e Argjinatures Veriore të Lagunës së Karavastasë prej Erozionit, Faza I”**, synon të formatojë me skarpate të rregullta argjinaturën në anën veriore të lagunës nga Pk. 2 deri te Pk.119 gjithësej 2360 m, dhe detajon masat për mbrojtjen e argjinaturës nga erozioni i shkaktuar nga veprimi i dallgës + baticë zbaticës në lagunë si dhe nga erozioni që shkaktojnë rrebeshët e shiut. Duke qenë një zonë e mbrojtur, materialet që do të përdoren për mbrojtjen e argjinaturës të jenë zgjedhur miqësore me mejdisin. Kurora e argjinaturës të shërbejë si atraksion turistik që të ecin këmbësorët për të shijuar bukuritë natyrore që ofron laguna. Mbi argjinaturë do të ndërtohen tre tenda pushimi e vrojtimi me material druri, si dhe një urë po me material druri, lidhëse e argjinatures ndërmjet Pk.119 dhe Pk.119 + 34 m pasi ndërmjet këtyre piketave, futen në lagune Kanali DK3-4 dhe përroi i Xengut. Argjinatura do të vazhdojë deri në Pk.121.Laguna e Karavastasë ndodhet në qendër të Ultesirës Perëndimore të vendit tonë dhe bën pjesë në parkun kombëtar të Divjakes. Është laguna më e madhe në Shqipëri dhe në gjithë bregdetin jugor të Adriatikut. Laguna është e përbërë prej një lagune të brendshme dhe një lagune të jashtme më të vogël. Tre kanale e lidhin lagunën me detin Adriatik. Siperfaqja e lagunës është 4330 ha, gjatësia 10.6 km, gjerësia 4.3 km dhe thellësia deri në 1.5 m. Kripësia në dimër shkon deri në 19 g/kg, kurse në verë mund të arrijë 35 g/kg. Laguna ndahet me detin nga një brez i gjerë rëre, Plazhit i Divjakës, dhe nga pyllit me pisha i Divjakës. Lidhet me detin me tri kanale, njëri prej të

cilëve artificial, i hapur për nevojat e peshkimit. Nëpër këto kanale, si pasojë e baticës dhe zbaticës, rrjedhja e ujit ndryshon drejtim çdo 6 orë. Gjatë një cikli të baticë-zbaticës shkëmbimi i ujit me detin arrin afërsisht 1/50 e volumit të gjithë lagunës.

SITUATA AKTUALE E LAGUNES

Si rezultat i dëmtimit ndër vite të argjinaturës së lagunës, pothuasje në të gjithë gjatësinë e saj, laguna shpesh nga batica, era dhe stuhitë detare, del nga shtrati, dhe përmbyt një pjesë të madhe të tokave bujqësore, të cilat janë nën nivelin e detit. Përmbytjet e tokave bujqësore, shkaktojnë dëme për fermerët të cilët jetësen e tyre e sigurojnë me veprimtarinë bujqësore. Për të eliminuar sipërfaqen e përmbytjes së tokave bujqësore, në anën Veriore të lagunës është ndërtuar një argjinaturë dhe me gjatësi 2.36 km. Kullimi i tokave pas argjinature është sistemuar me kanal anësorë paralel me argjinaturën. Është ndërtuar një hidrovor me kapacitet $3 \times 1.25 = 3.75 \text{ m}^3/\text{s}$ (dy pompa në punë një rezervë) i cili ujin që mblidhet në kanalin kullues e shkarkon brenda në lagunë. Materiali me të cilin është ndërtuar trupi i argjinaturës, kryesisht është marrë duke gërmuar në kanalin kullues që është në anë të argjinaturës. Këto janë kryesisht llume argjilore të kripura të përziera me rëra të cilat krijojnë dhera pa kohezion. Të përdorura në argjinatura nga veprimi i dallgës krijojnë gërryerje dhe filtrime të cilat për periudhe të shkurtër e shkatërrojnë argjinaturën, ndërsa nga veprimi i reshjeve atmosferike, uji futet në të çarat dhe plasaritjet e dherave dhe shkatërron argjinaturën.



Gjendja ekzistuese e argjinaturës së Lagunë

Punimet e Dheut dhe Argjinatures

Ka argjinaturë ekzistuese të plotë në një gjatësi rreth 2360 m në zonën e projektit. Pjesa tjetër do plotësohet. Kjo argjinaturë është ndërtuar me dherat që janë marrë duke gërmuar në kanalën kullues që shtrihet paralel me argjinaturën. Argjinatura ekzistuese nuk është e formatuar në skarpate të rregullta. Duke qënë se këto dhera kanë në përberje rëra, janë pa kohezion dhe argjinatura në disa vende siç është treguar në gjëndjen ekzistuese ka filluar të shkatërrohet nga erozioni i veprimit të dallgëve si dhe veprimit të baticë zbaticës. Kuota e argjinatures ekzistuese në përgjithësi është +1.5 m mbi nivelin e detit, por duke mos patur një formatim të rregullt në shumë vende ndryshon në gjerësi dhe lartësi. Janë bërë takime me specialistë që menaxhojnë sistemet e kullimit dhe që punojnë në hidrovorin e zonës veriore të lagunës në lidhje me problemet që ka pasur kjo argjinaturë gjatë funksionimit në situatat problematike. Në përgjithësi shqetësimet e tyre janë se erozioni po e dëmton argjinaturën, ndërsa dallgët maksimale asnjëherë nuk e kanë kaluar kuotën e argjinaturës ekzistuese.

Kontrolli dhe testimi i cilësisë

Pëlhura gjeotekstile e përdorur për prodhimin e dyshekut të gjeotekstitit duhet të ketë veti të larta mekanike për qëndrueshmëri të shtuar së bashku me shpim, gërryerje dhe rezistencë të shtuar ndaj rrezeve ultraviole.

Fijet për qepje duhet të jenë në përputhje me specifikimet standarde dhe të sillen në vend në paketimin origjinal të prodhuesit.

Prodhuesi duhet të ketë sisteme cilësie të çertifikuara ISO 9001:2015 së bashku me pajisjet e testimit të brendshëm dhe do të ketë laborator të brendshëm të akredituar ISO/IEC 17025:2017.

Prodhuesi duhet të dorëzojë Certifikatën CE nga një prej agjencive evropiane për gjeotekstilet jo të endura. Prodhuesi duhet të lëshojë një raport testimi që tregon vetitë e materialit, në momentin e dërgesës së kryer. Prodhuesi duhet të ketë një strukturë të brendshme testimi që ka dispozita testimi për metodat e provës siç përmendet më poshtë.

Kontrolli i cilësisë së prodhimit

Komponentët dhe GCL përfundimtar do t'i nënshtrohen testimit të rregullt dhe të shpeshtë në laboratorët e prodhuesit sipas standardit të menaxhimit të cilësisë ISO 9001 (2008).

GCL do të testohet për pajtueshmërinë me këtë specifikim nga metodat e provës dhe frekuencat e treguara në specifikimin e materialit ose sipas rastit.

Certifikatat e kontrollit të cilësisë do t'i lëshohen nga prodhuesi GCL kontraktorit. Certifikatat duhet të jenë të nënshkruara nga menaxheri i kontrollit të cilësisë së prodhuesit të GCL.

Se bashku me certifikatat e kontrollit të cilësisë, GCL do të shoqërohet dhe me udhëzimet e prodhuesit.

Vendosja e kornizës mbajtëse të rrugës.

Mbi membranën me argjilë gjeosintetike (GCL) do të vendoset një kornizë me profile metalike për të mbajtur paketën e rrugës. Korniza do të ketë në të dy anët profil metalik L me përmasa 150 x 90 x 12 mm dhe cdo 2.5 m gjatësi do të ketë një shirit drejtëkëndor metalik me përmasa 100 x 10 mm siç është treguar në figurën 55 dhe në vizatimin e projektit. Profilet metalike në përputhje me

standartin EN 10056-1:1999 Specification for structural steel equal and unequal angles – Dimensions L-Sections, Steel Angles

EN 10056-1:1999 Specifikimi për çelik strukturor me kënde të barabarta dhe të pabarabarta
Shiriti drejtëkëndor metalik me përmasa 100 x 10 mm në përputhje me standartin


BS EN 10111:2008 Continuously hot rolled low carbon steel sheet and strip for cold forming – technical delivery conditions

BS EN 10111:2008 Fletë dhe shirita çeliku me pak karbon të mbështjellë vazhdimisht të nxehtë për formim të ftohtë - kushtet teknike të dorëzimit

Seksioni tërthor tip i argjinaturës.

Seksionet tipe të argjinatures janë marrë në përshtatje me përmasat aktuale të argjinaturës, duke bërë formatimin e argjinaturës dhe duke mbajtur nën kontroll sasinë e dherave ekzistuese. Do të ketë 5 tipe seksione tërthore të argjinature me gjerësi të kurorës 3.0 m, 3.5 m, 4.0 m, 4.5 m dhe 5.0m. Pjerrësia dhe lartësia do të jetë e njëjtë për të gjitha seksionet.




SEKSIONI TIP I ARGJINATURES



Seksioni tip i argjinaturës.

Pjerrësitë e argjinaturës janë përshtatur me shpatet maksimale të lejueshme për gërmim më pak se 20 këmbë (6,09 m) bazuar në llojin e tokës dhe janë si më poshtë:

Soil Type	Height/Depth ratio	Slope Angle
Stable Rock	Vertical	90 deg.
Type A	¾ : 1	53 deg.
Type B	1 : 1	45 deg.
Type C	1½ : 1	34 deg.

<p>TYPE A SOIL Simple Slope Excavation</p> 	<p>TYPE B SOIL Simple Slope Excavation</p> 	<p>TYPE C SOIL Simple Slope Excavation</p> 
--	--	---

Pjerrësitë maksimale të lejueshme për gërmim.

Pjerrësia e skarpatës në anën e brendëshme të argjinaturës (ana e lagunës) është mbajtur $H=1.5$ m $V=1.0$ m, ndërsa pjerrësia e skarpatës në anën e jashtëme të argjinaturës është mbajtur $H=2.0$ m $V=1.0$ m.

Gjatë krijimit të seksioneve të argjinaturës nga ana e brendëshme (ana e lagunës) do të mbahet parasysh që skarpatet do të formohen gjithmonë në gjermim (skarifikim), çdo seksion formohet dhe plotësohet me skarpatën e jashtëme të argjinaturës, siç është treguar në fletët e projektit.

Pas krijimit të plotë të seksionit të argjinaturës kurora dhe skarpatet do të ngjeshen.

Materiali do të kompaktësohet, në një përmbajtje me lagështi optimale, derisa të arrihet një minimum densiteti të thatësisë prej 90% të AASHTO të modifikuar kundrejt densitetit të thatësisë maksimale.



Për shembull një rul me vibracion me skedë teknik:

Pesha:	1600kg
Ngarkesa lineare statike:	9.4 kg/cm
Gjatësia e rulit:	900 mm
Kalimet:	≥ 8
Trashësia e shtresës së dheut që ngjashet:	15cm

Mbrojtja E Argjinaturës Nga Erozioni


Në ditët e sotme, përparimet në teknologjinë gjeosintetike dhe zhvillimi i materialeve inovative me qëndrueshmëri dhe përshkueshmëri të përmirësuar ofrojnë performancë dhe jetëgjatësi më të lartë. Për mbrojtjen e argjinatures nga erozioni I shkarkuar nga veprimi I dallges + batices zbatices ne lagune si dhe nga erozioni qe shkaktojne rrebeshet e shiut ne karpatet e argjinatures do te perdoren dysheke gjeotekstili te mbushur me rere (sand filled mattres).

Një dyshek i mbushur me rërë, është një strukturë fleksibël dhe e qëndrueshme që përdoret për aplikime të ndryshme inxhinierike civile dhe mjedisore.

Përdoret gjerësisht për mbrojtjen e vijës bregdetare, stabilizimin e brigjeve të lumit, punimet e bonifikimit, kontrollin e erozionit dhe stabilizimin e pjerrësisë etj. Dysheku përbëhet nga një pëlhurë gjeotekstili e depërtueshme, e cila lejon që uji të rrjedhë duke mbajtur mbushjen e rërës. Dyshekët e mbushur me rërë ofrojnë një zgjidhje me kosto efektive dhe miqësore me mjedisin për këto aplikime, duke siguruar qëndrueshmëri dhe mbrojtje afatgjatë.

Pas instalimit, ai siguron mbrojtje të menjëhershme dhe të përhershme të argjinatures, duke sjellë një pamje estetike. Në fotot 33, 34 dhe 35 janë treguar aplikime të dyshekeve prej gjeotekstili të mbushur me rere, në skarpate të rezervuareve me uje të vaditjes dhe skarpateve të argjinaturave të kanaleve kulluese në tokat bujqesore.

Planimetria e pergjitheshme e projektit




Argjinatura e Projektit Ortofoto (Faza e I)



Ortofoto e Projektit

<https://geoportal.asig.gov.al>
Data e Printimit: 18.05.2024.

454811.584
4543081.365



479535.584
4543081.365

454811.584
4527373.365

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna
gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike
përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e
autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 1250 2500 5000 m

Legjenda

Ortofoto
2018 8

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH

479535.584
4527373.365

Tabela Nr. 1 Koordinatat e zones sipas sistemit Gauss- Kruger Zone 4

<i>Nr.</i>	<i>E</i>	<i>N</i>
1.	4373565.85	4540178.86
2.	4373782.70	4540039.14
3.	4373977.09	4539894.08
4.	4374025.65	4539487.42
5.	4374009.04	4539504.42
6.	4374849.67	4539419.17
7.	4375068.97	4539003.56
8.	4375075.81	4538989.48

Tabela Nr. 2 Koordinatat e zones sipas sistemit KRGJSH

<i>Nr.</i>	<i>E</i>	<i>N</i>
1.	457591.01	4539080.65
2.	457809.41	4538943.45
3.	458005.41	4538800.65
4.	458058.61	4538394.65
5.	458041.81	4538411.45
6.	458883.21	4538335.85
7.	459107.21	4537922.85
8.	459114.21	4537908.85

a) Përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes bimore ku propozohet të ndërtohet projekti dhe fotografitë përkatëse.

Laguna e Karavastasë ndodhet në qendër të Ultesirës Perëndimore të vendit tonë dhe bën pjesë në parkun kombëtar të Divjakes. Është laguna më e madhe në Shqipëri dhe në gjithë bregdetin jugor të Adriatikut. Laguna është e përbërë prej një lagune të brendshme dhe një lagune të jashtme më të vogël. Tre kanale e lidhin lagunën me detin Adriatik. Lidhet me detin me tri kanale, njëri prej të cilëve artificial, i hapur për nevojat e peshkimit. Nëpër këto kanale, si pasojë e baticës dhe zbaticës, rrjedhja e ujit ndryshon drejtim çdo 6 orë. Gjatë një cikli të baticë-zbaticës shkëmbimi i ujit me detin arrin afërsisht 1/50 e volumit të gjithë lagunës.

Habitatet dhe Biodiversiteti

Tabela më poshtë paraqet një listë të të gjitha llojeve të habitateve të vendosura brenda rajonit të studimit, emrat dhe kodet e të cilëve korrespondojnë plotësisht me klasifikimin sipas NATURA 2000 ose Aneksit I të Direktivës 92/43/KEE të Komunitetit Evropian.

Tabela 1: Emri dhe kodi i habitatit sipas Natura 2000

Nr.	Përcaktimi i habitatit	Kodi i habitatit sipas Natura 2000
1	Grykë-derdhja e lumenjve Shkumbin dhe Seman (grykë-derdhje)	1130
2	* Laguna bregdetare e Karavastasë, Osmanit, Godullat	1150
3	Vegjetacion njëvjeçar mbi depozitimet detare	1210
4	Salicornia dhe lloje të tjera njëvjeçare që kolonizojnë toka argjilore dhe ranore	1310
5	Livadhe të kripura mesdhetare (Juncetalia maritimi)	1410
6	Vegjetacion shkurrëzash halofile mesdhetare dhe termo- Atlantike (Sarcocornetea fruticosi)	1420
7	Duna embrionale mesdhetare	2110
8	Duna të lëvizshme të kordonit bregdetar me Ammophila arenaria	2120
9	*Duna bregdetare me Juniperus oxycedrus subsp. macrocarpa	2250
10	*Pyje bregdetarë të dunave ranore me Pinus halepensis, P. pinea, P. pinaster	2270
11	Shoqërime të larta helofitike të buzëujrave të përfaqësuar nga breza të kallamishteve (Phragmites australis)	3150

12	Lumenj Mesdhetarë me rrjedhje të vazhdueshme të karakterizuar nga breza pyjore me dominance të Salix dhe Populus alba	3280
13	Galeri dhe zabele jugore (Nerio-Tamaricetea dhe Securinegion tinctoriae)	92D0
14	Toka bujqësore	

• 1150 - * Laguna bregdetare e Karavastasë, Osmanit, me pellgje të shumtë, dhe Godulla me ujë të kripur.

Në përgjithësi lagunat përbejnë sipërfaqe ujore me ujëra të kripura deri në nivele të njelmëta, gjithmonë në varësi të sasisë së reshjeve, avullimit, depërtimit të ujërave të detit gjatë motit me stuhi, ose si rezultat i fenomeneve të baticave. Për lagunën e Karavastasë, pellgjet e shumtë me ujë të kripur dhe lagunat që ndodhen brenda territorit të ekosistemit karakteristik të ligatinave, me përhapjen më të madhe, shoqërohen me specien karakteristike si *Zostera nolti* (bari i detit). Ajo formon popullsi të pastër në formën e "livadheve nënujore" që mbulojnë 40-50% të sipërfaqes totale të fundeve të tyre gëlqerore, deri në thellësi rreth 1.3 m, por është më e pranishme në vende të cekëta (thellësi 20-30 cm), gjë që shoqërohet me shfaqjen në masë të *Zostera nolti* mbi sipërfaqen e ujit. Po kështu haset edhe në kanalet që lidhin lagunën me detin. Shoqërimi është i tipit pionier dhe zakonisht është monofitik, sidomos në afërsi të bregut (0.3-1 m), ndërsa në brendësi lloji karakteristik që shoqërohet me *Zostera nolti* është *Ruppia cirrhosa*.

Vegjetacioni me alga i këtij shoqërimi ndryshon sipas kripshmërisë dhe thellësisë. Janë hasur algat: *Chaetomorpha linum*, *Cladostephus verticillatus*, *Sania Rubens*, *Cystoseria sp.* etj.

Zostera nolti (bari i detit) dhe *Ruppia cirrhosa* (bari spiral), së bashku me grupet ekologjike të specieve shoqëruese (kryesisht alga), përbejnë për lagunën një nga biocenozat më të rëndësishme, e cila është burimi kryesor i prodhimit të oksigjenit, i nevojshëm për faunën ujore si dhe për strehimin dhe ushqyerjen e kësaj faune, veçanërisht peshqit.



Zostera nolti (bari i detit) (në të majtë) *Euphorbia paralias* (bima spirale e detit) në duna embrionike



Duna Bregdetare te levizshme me Ammophila arenaria (bar marami)

- 2250 - * Pyje bregdetare me *Juniperus oxycedrus* subsp. *macrocarpa* (nënlloj dëllinje kokërrmadhe) Pyjet bregdetare përbejnë fazën evolucionare të zhvillimit të dunave ranore drejt shoqërimeve bimore të klasës *Quercetea ilicis* të dominuara nga pisha mesdhetare. Këto pyje janë të vendosura mbi duna gjysëm të stabilizuara relativisht të pasura me substanca organike, rrjedhojë e dekompozimit të vegjetacionit të këtij brezi apo edhe materialeve të tjera të ardhura nga erërat detare. Dëllinja kokërrmadhe (*Juniperus oxycedrus* subsp. *macrocarpa*) përbën specien mbizotëruese në këto duna dhe zakonisht ka lartësi më të madhe se speciet e tjera të shkurreve. Formacionet me *Juniperus oxycedrus* subsp. *makrocarpa* në dunat bregdetare ranore mbulojnë një zonë të konsiderueshme në pjesën veriore të Parkut, në jug të lagunës si dhe pothuajse në të gjithë zonat periferike të pyjeve me pisha. Në pyjet me pisha, në dyshtemenë e tyre me shkurre, kjo specie luan shpesh një rol shumë të rëndësishëm. Ajo ka rëndësi si një specie që rritet mirë në rërat bregdetare. Formacionet e mbizotëruara nga *Juniperus oxycedrus* subsp. *makrocarpa* përbëhen nga dy shtresa shoqëruese bimësie, dyshtemeja me shkurre dhe bari. Në katin e shkurreve, përveç *Juniperus oxycedrus* subsp. *macrocarpa*, përfshihet gjithashtu filizi i pishës së egër (*Pinus halepensis*) dhe filizi i pishës së butë (*Pinus pinea* L.).



Duna bregdetare me Juniperus oxycedrus subsp. macrocarpa (nënlloj dëllinje kokërrmadhe)

Ky lloj habitati ka status të vecantë dhe është përfshirë në Aneksin I të Direktivës 92/43/KEE. Prania e kësaj specie është një faktor i rëndësishëm në parandalimin e lëvizjes së rërës për shkak të erërave të detit drejt kontinentit.

2270 - * Pyje bregdetarë të dunave ranore me *Pinus halepensis*, *P. pinea*, *P. pinaster* (pisha halore). Ato shtrihen nga gryka e lumit Shkumbin, në veri, deri në dalje të Semanit, në jug, me një gjatësi prej rreth 10 km dhe gjerësi prej disa qindra metrash (deri në 1 - 1.5 km) dhe një sipërfaqe totale prej 1100 ha. Në lindje këto pyje kufizohen me ligatina, laguna ose toka bujqësore, ndërsa në perëndim me zonë ranore. Pjesa e ruajtur më mirë është ajo veriore e njohur si "Oazi".



Pyje bregdetarë të dunave ranore me Pinus halepensis, P. Pinea (pisha halore)

Në këtë pyll ka një shtresë me drurë e mbizotëruar kryesisht nga pisha e egër dhe në një masë më të vogël, nga pisha e butë. Përveç këtyre dy specieve gjejmë dhe Vidhin e vogël (*Ulmus minor*), Frashërin fletë ngushtë (*Fraxinus angustifolius*), Lisin qershi (*Quercus robur*), Plepin e bardhë (*Populus alba*), Vërriun e zi (*Alnus glutinosa*), etj. Shtresa e shkurreve është më e dendur dhe mbulon pothuajse 80% të sipërfaqes totale. Shkalla e mbulimit të këtij kati, dominimi i një specie apo një tjetri varen drejtpërdrejt nga mikroklimat, por në shumë raste janë dhe rezultat i veprimtarisë antropogjene. Në mjaft raste, kjo shtresë paraqitet e ndërthurur me liana të shumta si morenxa (*Smilax aspera*), Urthi (*Helix Hedera*), Hardhia e egër (*Vitis vinifera* subsp. *silvestris*), Shtalpra (*Periploca graeca*), Kulpëra e butë (*Clematis flammula*), etj. Me interes të veçantë për florën barishtore të këtij formacioni janë speciet me status shumë të kufizuar dhe endemik në zonën shqiptare: *Galatella albanica* (*Asper shqiptar*), *Orchis albanica* (*Orkideja e Divjakës*) dhe një formë hibride: *Orchis x paparistoi* (*O. albanica x O. carioophora*). Edhe ky lloj habitati ka statusin e vecantë pasi është i përfshirë në Shtojcën I të Direktivës 92/43 / EEK. Përveç llojeve të lartpërmendura të habitatit me statusin e vecantë (Shtojca I e Direktivës 92/43 / EEE) në rajonin në studim ekzistojnë gjithashtu një numër i madh habitatesh të tjerë që ia vlen të përmenden, siç janë kënetat dhe livadhet e kripura kontinentale, më të përhapurit nga cilat janë:

- 1310 - Ambruku (*Salicornia*) dhe kolonizues të tjerë të tokave argjilore dhe tokave ranore shumë të kripura

Përfshin shoqërime bimore të tokave shumë të kripura me përhapje shumë të madhe në këtë rajon pas dunave të rërës. Ky lloj habitati mbizotërohet në shumicën e rasteve nga familje njëvjeçare si Chenopodiaceae (*Chenopodiaceae*) të gjinisë së Ambruk-ut (*Salicornia*). Lloji dominues i këtyre mjediseve, Ambruku (*Salicornia europaea*), është bima e parë që rritet në një mjedis me shkallë kaq të lartë të kripës në tokë.

- 1410 Livadhet e kripura mesdhetare (*Juncetalia maritimi*)

Ky lloj habitati përfaqësohet nga shoqërime të ndryshme mesdhetare të rendit detar *Juncetalia* dhe përfshin zona të mëdha sidomos në zonat përreth lagunës së Karavastasë, lagunës së Godullave dhe lagunës së Osmanit, por edhe në gropore brenda Mesdheut ose pyjeve halore aluviale. Është pjesë e bimësisë së specializuar të tokave të kripura. Karakterizohet nga mbizotërimi i Kulmakut bregdetar (*Juncus maritimus*) dhe Xunkthit të butë (*Juncus acutus*) shpesh me një prirje për të krijuar popullata të pastra.

- 1420 Bimësia e shkurreve halofile mesdhetare dhe termo-atlantike (*Sarcocornetea fruticosi*)

Përfaqëson bimësi shumëvjeçare të kënetave të kripura bregdetare të përbërë kryesisht nga shkurre mesdhetare-atlantike si Ambruku (*Salicornia*), Livanda e detit (*Limonium vulgare*), Sveda (*Suaeda*) dhe Laboti (*Atriplex spp.*) dhe që i përkasin klasës *Sarcocornetea fruticosi*. Këto shoqërime në groporet më të thella rreth lagunës së Osmanit dhe në shumë raste edhe prapa dunave të rërës mbulojnë një zonë të madhe.

- 3150 - Shoqërime të larta të buzëujrave të përfaqësuar nga breza të kallamishteve (*Phragmites australis*)

Shoqërimet bimore të lumenjve ose liqeneve, kënetave ose ligatinave me lagështi eutrofike, të formuara nga shoqërime të lagështisë së lartë, të tilla si Kallamishtja (*Phragmites australis*), Shavari gjethengushtë (*Typha angustifolia*) dhe grupi latifitra, kryesisht speciet e *Scirpus* ose gjethe rënës, speciet helofite. Shoqërimi dallohet për një produktivitet të lartë biologjik, veçanërisht kallmishtja.



Brezi i Kallamishteve (Phragmites australis), përgjatë lumit Shkumbin

- 92A0 - Pyje aluviale mesdhetare ose bregore të lumenjve me plepa dhe shelgje të bardhë (*Populus alba*, *Salix alba*) Ndër shoqërimet bimore të zakonshme në rajonin e studimit është plepi i bardhë (*Populus alba*). Plepi i bardhë në këtë rajon formon pyje me shumë shtresa, të përhapura kryesisht në zonat fushore të bregut të lumit Shkumbin, që janë përmytur vazhdimisht dhe për një kohë të gjatë, në toka të rënda dhe pak të depërtueshme nga uji (Kular).
- 92D0 Shkurre detare dhe halore të Evropës jugore si Bruka (*Tamarix spp.*) dhe konopica

(*Vitex agnus castus*)

Shoqërimet bimore të brigjeve të lumenjve ose liqeneve, lumenjve, liqeneve, kënetave apo ligatinave, ku dominojnë Bruka e dalmacisë (*Tamarix dalmatica*), konopica (*Vitex agnus-castus*) dhe më rrallë Bruka hampeana (*Tamarix hampeana*), zakonisht shumë të varfër në përbërjen floristike dhe shpesh ndahen në monodominante, tolerante dhe me luhatje në nivelin e kripës. Ky lloj habitati në rajonin e grykëderdhjes së Shkumbinit ka një përhapje fragmentare, përgjatë rrjedhës së lumit Shkumbin në formën e brezave shpesh me gjerësi të konsiderueshme, në groporet midis dhe prapa dunave të stabilizuara të rërës, shpesh të përmytura nga uji i shiut, por si rezultat i tokave ranore ujërat filtrohen shpejt dhe koha e përmytjeve të tyre është e shkurtër



Flora dhe Fauna

Laguna strehon një numër të madh zogjsh uji shtegëtarë. Në brendësi të saj ka dhe ishuj të vegjël, në të cilin folezizojnë shpendët. Karakteristike në këtë zonë është kolonia e Pelikanit Kaçurel me rreth 60 çifte që përfaqëson rreth 5% të numrit të përgjithshëm të kësaj specie në shkallë botërore. E veçantë është dhe prania e disa qindra çifteve të dallandysheve të detit. Lloje të tjerë të zogjëve që jetojnë në lagunë janë: Lejleke, Pata e eger, Çafka e Madhe e Bardhë, Rosa e Egër, Thëllëza, Lauresha, Shqiponja e madhe, Shqiponja e detit, etj. Të numëruar deri ne 228 specie zogjsh. Janë rreth 29 lloje të ndryshme amfibësh dhe reptilësh (duke përfshirë Breshkën e ujit të detit) dhe 25 lloje gjitarësh duke përfshirë Vidrën, Nuselalën, Kaprollin dhe Dhelprën e kuqe.



Sopi i Gjatë Pelikani Kaçurel



Resurset Natyrore

Laguna e Karavastasë përbën një burim të ardhurash për popullsinë lokale që jeton brenda parkut tradicional. Këtu, njerëzit varen nga laguna për jetesën e tyre duke u marrë me restorante të vogla, duke zhvilluar guida për turistët dhe peshkim tradicional, duke respektuar teknikat dhe periudhat e peshkimit.



Impianti i Peshkimit në Kanalën te Ura Dalanit



Kullat e drurit, të ngritura në mes të pyllit, ka rritur numrin e grupeve familjare që dëshirojnë të shkojnë për të kaluar një drekë dhe për të ngjitur këto kulla 30 metërshe që u mundësojnë atyre të shohin mbi parkun me pisha të larta.

Zonat e Mbrojtura

Parku Kombëtar Divjakë- Karavasta ndodhet në kufirin perëndimor të zones së Projektit. Parku Kombëtar ka vlera të mëdha shkencore, ekologjike, didaktike, kulturore, turistike dhe ekonomike. Parku Kombëtar Divjakë- Karavasta është pjesë e Trashëgimisë Kombëtare Natyrore dhe sistemit të ligatinave të Divjakës dhe renditet në listën ndërkombëtare të vendeve Ramsar nën Konventën e Ligatinave Ndërkombëtare. Ruajtja e biodiversitetit dhe peizazhit natyror mbetet një qëllim kryesor në menaxhimin e këtij parku.

Në vitin 2003, në zonën e Divjakë - Karavastasë, ishin të pranishme këto zona të mbrojtura: Rezerva strikte e mbrojtur e Lagunës së Karavastasë, Pisha e Parkut Kombëtar të Divjakës, Zona e Menaxhimit të Kularit. Me vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 687, datë 19.10.2007) u përcaktua vetëm një zonë e mbrojtur e kategorisë së dytë: Parku Kombëtar Divjakë - Karavasta. Sipas këtij vendimi (VKM nr. 687, datë 19.10.2007) sipërfaqja e parkut është 22230.2 hektarë e ndarë në:

- Zona pyjore (pyje, pyje të rralla, pyje aluviale dhe shkurre, ripyllëzime, pyje dhe tokë me bimësi ujore) 5,310,00 hektarë;
- Sipërfaqja bujqësore (tokë bujqësore, pemishte, ullishte dhe vreshta) 9078,42 hektarë;
- Zona ujore (laguna, lumenj dhe ujëmbledhës) 6408,90 hektarë;
- Zona joproductive (ranore dhe e zhveshur) 1120,71 hektarë;
- Zona urbane e përzier me toka bujqësore, pemishte dhe pyje 312, 21 hektarë.


Për qëllime administrimi parku është i ndarë në katër zona:

- Nënzona Qendrore, me një sipërfaqe prej 4189.70 hektarë: Pisha e Divjakës; Habitatet e Kularit, Këneta e Dajlanit; ishujt e foleve të Pelikanit Dalmacisë.

VNM- PARAPRAKE

- Nënzona e Përdorimit të Qëndrueshëm, me një sipërfaqe prej 7788.44 hektarë: Laguna e Karavastasë, zonë midis dy brigjeve të lumit Shkumbin; territoret e Kularit dhe Sulzotajt; territoret midis pellgjeve ujëmbledhëse të Myzeqesë dhe Semanit.
- Nënzona e përdorimit tradicional, me një sipërfaqe prej 9261.87 hektarë. Territoret bujqësore; zonat përreth qendrave të banimit; Bedati; kodrat e Divjakës. Lejohen aktivitetet tradicionale ekonomike.
- Nënzona rekreative, me një sipërfaqe prej 990.23 hektarësh: vija bregdetare, zona e plazhit dhe zona e pyllit me pisha. Parku Kombëtar Divjakë - Karavasta ka 8 monumente natyrore.
- Zonat e Mbrojtura sipas VKM nr. 413 datë 22.08.1994 dhe VKM nr. 781, datë 29.11.1995 Laguna e Karavastasë, kënetat, Pisha e Divjakës (brigjet e Adriatikut) janë pjesë e Listës Botërore të Konventës Ramsar. Kjo listë përfshin ligatinat e Butrintit, (bregdeti Jon) dhe zonën e liqenit të Shkodrës-Buna-Velipojë (bregdeti Adriatik).

Ne ortofoton me poshte tregon projektin qe ndodhet ne zone te mbrojtur.



Monumentet natyrore në Parkun Kombëtar Divjakë-Karavasta

VKM-ja nr. 676, datë 22.12.2002, ka shpallur tetë monumente natyrore në këtë zonë, ndër të cilat katër janë gjeo-monumente, njëri është hidro-monument dhe tre janë bio-monumente. Gjeo-monumente:


- *Ishulli i Pelikanit*. Ndodhet në Lagunën e Karavastasë, rreth 0.5 m mbi nivelin e detit. Ishulli është formuar nga akumulimi i mbetjeve organike dhe reflekton një formacion shumë të pasur të barishteve dhe pemëve. Pelikani Dalmacisë ndërton çerdhen në këtë ishull.

- *Ishulli i Kularit.* Ndodhet në grykëderdhjen e Shkumbinit, me lartësi rreth 0,5 m mbi nivelin e detit. Ai është formuar nga akumulimet që sjell lumi. Flora e tij është shumë e pasur, e përfaqësuar nga pemë dhe shkurre, ku jeton një faunë e pasur, veçanërisht zogjtë e detit, ndër të cilët dallim bën pelikani Dalmacisë.
- *Kordoni i ri litoral i lagunës së re të Divjakës.* Ndodhet në perëndim të Lagunës së Divjakës, rreth 0,5 m mbi nivelin e detit. Ky kordon interesant është i formuar nga aktivitetet akumuluese të valëve të detit, të cilat me lëvizje në drejtim veri-jug kanë krijuar një lagunë të re në perëndim të lagunës së vjetër.
- *Dunat e oazit të Divjakës.* Ndodhen në plazhin e Divjakës. Ato përfaqësojnë një grup dunash të krijuara nga aktiviteti akumulues i erës në plazhin ranor. Dunat janë rreth 600 m të gjata, 25 m të gjera dhe 1,5 m të larta.

Bio-monumentet:

Pisha e egër në oazin e Divjakës: Ndodhet në pjesën veriore të pyllit të Divjakës (410 vjeçare).

- Kodra e Goricës në Kryekuq: Ndodhet disa metra në veri të qendrës së fshatit Kryekuq. Lartësia është 10-12 m dhe gjerësia e trungut është rreth 60 cm.
- Pemët e vidhit në Zharnec: Ato gjenden në varrezat e fshatit Zharnec. Janë 5-6 pemë vidhi në grup me lartësi rreth 5-6 m dhe trashësi të trungut rreth 35 cm.
- Kisha Bizantine e Karavastasë së Re (trashëgimi kulturore, shek. XVIII), është vlerë e shtuar në rrethinat e këtij parku



Trashëgimia kulturore

Nga ana gjeografike, zona e projektit ndodhet në pjesën perëndimore të Shqipërisë, pjesërisht në bashkinë Divjakë dhe pjesërisht në bashkinë Fier. Bashkia e Divjakës, kufizohet në veri me bashkinë Rrogozhinë, në lindje me bashkinë Lushnje, në jug me bashkinë Fier dhe me detin Adriatik në perëndim. Bashkia e re përbëhet plotësisht nga toka rurale dhe pjellore. Pjesë e territorit të saj është parku kombëtar Divjakë-Karavasta, si dhe plazhi i Divjakës. Peizazhet kryesore gjeografike janë laguna e Karavastasë, Lumi Shkumbin dhe Lumi Seman. Format kryesore të relievit janë përkatësisht kodra - 100 hektarë, fusha - 1800 hektarë, pyje - 1275 hektarë, dhe sipërfaqe ujore - 595 hektarë. Klima është mesdhetare me shumë kontraste midis stinëve. Aktivitetet kryesore ekonomike janë bujqësia, dhe në një masë më të vogël peshkimi në Lagunën e Karavastasë. Zona ka mundësi të mira për zhvillimin e turizmit detar dhe ekoturizmit. Vitet e fundit, turizmi i shikimit të shpendëve është shfaqur falë pranisë në Lagunën e Karavastasë të një kolonie të vogël të specieve pelikane të rrezikuara. Në territorin e saj ekzistojnë gjithashtu rezerva të gazit natyror që janë shfrytëzuar për disa vjet.

Bazuar në letërsinë e botuar, shihet se komuna Divjakë është shumë e pasur me burime kulturore, historike dhe arkeologjike. Interesi në studimin antik të kësaj zone të Myzeqesë daton që nga fillimi i shekullit XIX. Arkeologu i parë që ka përshkruar fushat e Myzeqesë në kontekstin historik ishte francezi François Pouqueville. Ai i botoi të dhënat e tij në librin "Udhëtime në Epir, Shqipëri, Maqedoni dhe Thesali"² në vitin 1820. Historiani francez, Robert Cyprien është një tjetër autor që ka publikuar të dhëna historike për këtë zonë. Në librin e publikuar në vitin 1844 me titull, Les Slaves de Turquie: Serbes, Monténégrin, Bosniaques, Albanais et Bulgares³. Vlen të përmendet edhe puna e bërë nga mësuesi vendas, Kol Nikaj. Gërmimet e para arkeologjike për në Rrethin e Divjakës u kryen nga arkeologu austriak Praschniker në vitin 19174. Ato u vazhduan nga arkeologu francez Leon Rey, në vitet 1930. Pas një periudhe të gjatë, në vitin 1956 gërmimet e para nga një arkeolog shqiptar u bënë nga Skënder Anamali. Në vitin 1977 u ndërmor një ekspeditë arkeologjike e udhëhequr nga arkeologu Neritan Ceka. Në vitin 1978, gërmimet në një varrezë në Gërmenj të Vogël "zgjeruan" në tej njohuritë për këtë zonë. Gërmimet e reja arkeologjike u intensifikuan më tej pas viteve 1980 me gërmime në vendbanimin e Babunjës⁵. Këto gërmime ofruan një inventar të pasur arkeologjik, si dhe informacione të përgjithshme mbi fillimet e këtij "qyteti". Një pjesë e mirë e gjetjeve të zbuluara në këtë vendbanim, janë të ekspozuara sot në pavijonin arkeologjik të Muzeut të Lushnjës dhe Muzeut të Divjakës. Në vitet 2003-2005 u bënë kërkime të tjera arkeologjike në territorin e Lushnjës. Qëllimi ishte identifikimi i rrugës së vjetër Egnatia⁶. Një studim tjetër intensiv është kryer në vendbanimin e Babunjës në vitin 2013. Në bazë të letërsisë së botuar dhe të dhënave ekzistuese, bashkia Divjakë mund të ndahet në katër zona kryesore që kanë ofruar gjetje të rëndësishme arkeologjike, mbetje arkitekturore dhe pasuri të tjera të Trashëgimisë Kulturore.

Divjaka - Në zonën kodrinore të Divjakës janë zbuluar objekte të shumta arkeologjike që datojnë nga Epoka e Gurit. Sipas dëshmimeve arkeologjike, zona është përdorur si vendbanim që nga Epoka e Gurit nga fiset ilire dhe gjatë Mesjetës. Ato përfshijnë copëza qeramike, armë, mjete të përdorura për punë bujqësore, koka shtizash, helmata, bizhuteri, stela dhe objekte të tjera që lidhen me aktivitetet e jetës së përditshme dhe ritualet funerale që datojnë nga

VNM- PARAPRAKE

parahistoria deri në mesjetë⁷. Zbulimet e shumta arkeologjike dëshmojnë rëndësinë dhe zhvillimin e zonës. Këto zbulime të rëndësishme përfshijnë objektet arkeologjike të gjetura te "Sopi i Mirë", duke rritur ndjeshëm numrin e objekteve arkeologjike të zbuluara aty. Me interes të veçantë është hapësira që vendasit e quajnë "Tjegullas". Këtu janë zbuluar copa të shumta pllakash, si dhe shumë qeramika të varura në mure të llojeve të ndryshme; madje, gjatë punimeve për hapjen e kanaleve të kullimit, u gjetën tre themele të ndryshme: Një themel prej guri dhe dy prej tullave. Pak më në veri, në një parcelë me toponimin "Vidhishta", gjatë punimeve bujqësore u nxorën në sipërfaqe fragmente tullash. Në themelet e tullave është përdorur gjithashtu llaç i hollë me gëlqere. Fragmente të tjera tullash dhe qeramike janë zbuluar në lindje të Divjakës, në vendin e quajtur "Rruga Samaritan", në fushat "Fija e hardhisë", "Vidhishta", "Bako", "Rostama", ose "Lera e lirit" etj.⁸ Karavasta, një fshat në komunën e Divjakës, emri i së cilës e ka origjinën nga një emër i lashtë Grek, që nënkupton port. Ai përmendet edhe në një dokument turk të vitit 1431, si një vendndodhje shumë e mirë detare. Në bazë të letërsisë së botuar, në fshat ka pasur një numër kishash të vjetra. Sipas vendasve, disa nga këto kisha janë të mbuluara nga deti, kënetat dhe argjinaturat sot. Aktualisht në fshatin e Karavastasë ndodhet kisha e Shën Thanasit, e ndërtuar 200 vjet më parë, e cila ruan shumë afreske që mbartin vlera kulturore dhe historike. Karavastaja përmendet edhe në një letër të vitit 1701, ku është urdhëruar që Liqeni i Plenës në Mallakastër dhe laguna e Karavasta, në Kaza e Myzeqesë, të kaloje drejteperdrejte në varesinë e mukates se Vlores. Kripa e Karavastasë shitej në tregjet e huaja, si në Itali, Greqi dhe Turqi. Në vitet 1940, Karavastaja ishte një çiflig i Ibrahim Bej Kavajës së Beratit. Më 1926, një grup njerëzish të pasur formuan Shoqërinë e Peshkimit të Karavastasë.

Babunja- Një fshat tjetër i bashkisë së Divjakës, që ndodhet në jug të kodrave të Karatoprakut, në anën e djathtë të shtratit të vjetër të lumit Seman. Ka dy lagje kryesore: Babunja e Vjetër e cila ndodhet në fushë dhe Babunja e Re e cila ndodhet në kodër. Në kohët e lashta në kodrën afër fshatit, gjendej dikur qyteti antik Arnisa, ai ishte i vendosur midis qyteteve antike të Apolonisë dhe Dyrrahut. Në këtë kodër janë zbuluar materiale arkeologjike (mure fortifikimi) të shekujve XIII-XII para Krishtit dhe materiale arkeologjike nga periudha proto-urbane. Në fortifikime dallohen gurët kuadratikë⁹ të bërë nga mjeshtrit, shumë prej të cilëve kanë shenjë e Damastion D. Një pjesë e këtij muri është ekspozuar në muzeun historik të Lushnjës. Aktiviteti më i madh, që qyteti i vjetër kishte në shekullin IV-III para Krishtit. Babunja njihet me këtë emër duke filluar që nga viti 1431 dhe 1533. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, fshati ofroi ndihmë për çlirimin e vendit, ku u krijua Këshilli Nacional Çlirimtar në qershor të vitit 1943 dhe u çlirua fshati në qershor të vitit 1944.

Çermë e Sipërme- Një fshat në bashkinë e Divjakës, me vendndodhje në anën e majtë të niveleve të poshtme të lumit Shkumbin, 15 km larg qytetit. Në afërsi të fshatit janë zbuluar objekte arkeologjike dhe një varrezë që daton nga periudha ilire, të cilat e dëshmojnë këtë zonë si një vendbanim duke filluar që nga shekulli II-IV. Njihet me këtë emër që nga viti 1582. Fillimisht vendndodhja e fshatit ishte mbi kodër dhe me kalimin e kohës u shtri përgjatë lumit Shkumbin. Lumi, në Antikitët, njihet si "Genus" dhe ishte i lundrueshëm. Në afërsi të lumit kalonte rruga Egnatia, e ndërtuar gjatë periudhës romake të shekullit të dytë para Krishtit. Ajo fillon në Romë. Në Shqipëri, ajo fillon nga Durrësi dhe kalon në shumë qytete, si Klodiana (Peqini), Skampia (Elbasani), Adquantum (Bradasheshi) dhe Lychnidos (Pogradeci)¹⁰. Ajo

VNM- PARAPRAKE

vazhdoi përmes Maqedonisë së Veriut, Greqisë, dhe përfundoi në Turqi. Në mesjetë, ajo njihej me emrin "Bregu". Në vitin 1570, citohet si Skampin (Shkëmb), emër që e mori nga qyteti i vjetër i Elbasanit (Skampa).

Gërmenj - Një fshat në bashkinë e Divjakës, i cili kufizohet në jug me fshatin Hallvaxhias dhe fshatin Bregas. Ai shtrihet në shpatin lindor të kodrave të Divjakës. Në kodrat e fshatit gjendet një varrezë parahistorike. Në varrezë janë zbuluar objekte që datojnë në epokën e Bronzit (vitet 3000-2100 para Krishtit), Epokën e Hekurit (1100-500 para Krishtit) dhe periudhat Romake dhe Mesjetare 11. Gjithashtu, në këtë fshat, gjendet një kishë e vjetër, rrënojat e së cilës janë ende të dukshme. Kisha nga vendasit quhet "Kisha Maku". Themelet e kishës gjenden në një kodër të lartë midis dy fshatrave. Në oborrin e kishës gjenden themelet e një teqeje të vogël. Përpara kishës, ndodheshin dy shtylla, të cilat mendohet se mund të jenë më të vjetra se vetë kisha.

Kushtet Klimatike

Klima në fushën bregdetare është tipike mesdhetare, me reshje mesatare prej 893 mm në Divjakë, Reshjet në Divjakë në një sasi prej 70 deri 75% ndodhin nga tetori në mars. Avullimi i vlerësuar nga të dhënat klimatike të stacionit të Mbrostarit (Instituti Hidrometeorologjik, 2001) arrin një vlerë vjetore prej rreth 1200 mm. Megjithëse ka një deficit hidro-klimatik, ky nuk është aq i rëndësishëm sa në zonat e tjera perëndimore të Mesdheut. Kjo do të thotë që edhe në pellgun e saj të kullimit, laguna është përballur gjithmonë me ndryshime të forta sezonale në regjimin e ujit dhe kripësinë, siç është e pritshme për lagunat bregdetare mesdhetare. Temperaturat maksimale dhe minimale janë vërejtur në gusht (maksimum) dhe janar, ndërsa reshjet më të ulëta ishin në gusht dhe më të lartat në nëntor. Evapotranspirimi më i lartë është vërejtur në korrik dhe gusht ndërsa më i ulët në muajt e dimrit. Deficiti i lagështisë, si në të gjithë zonën mesdhetare, është në sezonet e verës dhe vjeshtës deri në nëntor. Një faktor i rëndësishëm klimatike për hidrologjinë e lagunës është era, e cila lejon ujin të përzihet dhe rrit ose neutralizon efektin baticë në shkëmbimet e ujit të lagunës me detin. Gjatë muajve të pranverës dhe verës, drejtimi mbizotërues i erës (Instituti Hidrometeorologjik, 2001) është nga Veri- Perëndimi.


a) Informacion për praninë e burimeve ujore në sipërfaqen e zënë nga projekti dhe ne afersi të tij.

Zona përmban disa pasuri ujore:

- pjesa e detit Adriatik(over 4km),
 - laguna e Karavastase (over 4km),
 - Lumin Shkumbin (over 4km),
 - Lumi Seman(over 4km),
- Kanalet kryesore drenazhuese të Tërbufit dhe Myzeqesë (rreth 20km), etj.
- Lumi Seman (rreth 500 m në J-L të projektit) është një nga lumenjtë më të rëndësishëm dhe më me interes të hidrografisë së Shqipërisë. Ai ka një pellg ujëmbledhës prej $F=5649\text{km}^2$, lartësi mbi nivelin e detit $H=889\text{m}$ dhe gjatësi $L=281\text{km}$. Ka dy degë: Lumi Osum ($F=2073\text{km}^2$, $H=852\text{m}$) dhe Lumi Devoll ($F=3122\text{km}^2$, $L=193\text{km}$). Moduli mesatar vjetor prurje-shkarkim për zonën ujëmbledhëse të Lumit Seman është $q_0=16,4\text{l/s}\cdot\text{km}^2$, ndërsa koeficienti mesatar i prurjeve është $\alpha_0=0,49$. Masa maksimale e rrjedhës me probabilitet $p=1\%$ për Devollin (në Kozarë) është $Q_{p1\%}=1790\text{m}^3/\text{s}$, ndërsa për Osumin (tek Ura Vajgurore) është $Q_{p1\%}=1290\text{m}^3/\text{s}$. Masa totale e shkarkimit të sedimenteve për lumin Seman është $\dot{E}T=15630 \times 10^3\text{ ton/vit}$, nga e cila rreth 20%, (ose $P=3130 \times 10^3\text{ ton/vit}$), është ngarkesë e shtratit, ndërsa rreth 80%, ($\dot{E}F=12500 \times 10^3\text{ ton/vit}$), është sediment pezull.
- Lumi Shkumbin (rreth 20 km në Veri të projektit) e ka burimin në lindje të Maleve të Valamarës (Juglindja e Shqipërisë) dhe rrjedh brenda një lugine të ngushtë dhe të thellë midis Maleve të Mokrës dhe Shebenikut, në lindje, dhe Maleve Polis në perëndim. Lumi Shkumbin ka një pellg ujëmbledhës prej 2459km^2 , me shpejtësi të rrjedhës $48\text{m}^3/\text{sek}$, një prurje mesatare vjetore prej $6,78 \times 10^6\text{ ton}$ dhe është 187.4 km i gjatë. Në fundin e rrjedhës lumi kalon nëpër Fushën e Myzeqesë për rreth 35-40km, duke gjarpëruar përmes saj dhe duke formuar një deltë të vogël në Lagunën e Karavastasë.

Si Lumi Seman ashtu edhe Lumi Shkumbin kanë pësuar ndërhyrje të ndryshme nga dora e njeriut: prishje të zonës ripariane, shfrytëzim të materialit inert (rërë, zhavorr, gurë), shembje të argjinaturës, të cilat kanë çuar në tjetërsimin e hidro-morfologjisë së tyre. Këto ndërhyrje, së bashku me ndryshimin e klimës, kanë sjellë disa pasoja, siç janë:

- i) ulja e shtratit të lumit për shkak të erozionit të tij të poshtëm,
- ii) përmytje në zonën e poshtme,
- iii) erozion të tokës bujqësore,
- iv) - shkatërrim të argjinaturave,
- v) ulje të nivelit të ujërave nëntokësore në burimet e ujit.



Projekti ne studim do te jete "Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I.

b) Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër.

Ky raport hartohet mbi bazen e parimit të mbrojtjes së mjedisit dhe në funksion të institucioneve vendim-marrese për licensimin ose jo të aktiviteteve të ndryshme të cilat mund të kenë ndikim në mjedis.

Me mbrojtje të mjedisit do të kuptojmë veprimtaritë të cilat zhvillohen duke pasur parasysh parimet baze të mbrojtjes së mjedisit të cilat janë:

- ❖ Parimet e mbrojtjes së mjedisit
- ❖ Parimi i zhvillimit të qëndrueshëm
- ❖ Parimi i parandalimit dhe marrja e masave paraprake
- ❖ Parimi i ruajtjes së burimeve natyrore
- ❖ Parimi i zëvendësimit dhe/ose kompensimit
- ❖ Parimi i qasjes së integruar
- ❖ Parimi i përgjegjësisë së ndërsjelle dhe bashkëpunimit
- ❖ Parimi "Ndotesi paguan"
- ❖ Parimi i së drejtës për informim dhe i pjesëmarrjes së publikut
- ❖ Parimi i nxitjes së veprimtarive për mbrojtjen e mjedisit

Mbrojtja e mjedisit nënkupton mbrojtjen e integruar të perberësve të mjedisit nga ndotja, si vecmas, ashtu dhe në kombinim, duke pasur parasysh ndërveprimet ndërmjet tyre dhe qysh në fazën e planifikimit të zhvillimit të një territori të caktuar.

Mbrojtja e perberësve të mjedisit klasifikohet në:

- ❖ Mbrojtja e ajrit
- ❖ Mbrojtja e ujerave
- ❖ Mbrojtja e tokës
- ❖ Mbrojtja e natyrës
- ❖ Ndryshimet klimatike

Ky ndertim do të kryhet mbi një sipërfaqe tokë të lire nga ndertimet e cila nuk përdoret: as për bujqësi; nuk ka bimesë të lartë, nuk ka park natyror, nuk ka demtime të bimesës së zonës.

Bazuar në llojin e projektit të propozuar ndikimet më thelbësore mund të analizohen sipas dy fazave të veprimtarisë:

- ❖ Në fazën e ndërtimit
- ❖ Në fazën e funksionimit

Rendesi ka të kuptohet natyra e këtyre proceseve dhe forma e shfaqjes së tyre, direkte apo indirekte, në mënyrë që të përcaktohet qartë lloji i ndikimeve.

Duke analizuar edhe shtrirjen në tokë të këtyre ndikimeve, ato klasifikohen në:

- ❖ Ndikim e të kthyeshme në mjedis
- ❖ Ndikime ta pakthyeshme në mjedis

Të dy llojet e ndikimeve mund të minimizohen në terma relative ku qëllimi kryesor është mbajtja e tyre brenda sipërfaqes së objektit të kërkuar dhe krijimi i kushteve natyrore për të siguruar riaktivizimin e proçeseve të natyrës dhe rigjenerim të ekosistemit.

Për vlerësimin e ndikimeve në mjedis të projektit u ndoqën hapat e mëposhtëm:

- ❖ Njohja me projektin dhe fazat e zbatimit të tij.
- ❖ Njohja me natyrën e operacioneve të nevojshme në mjedis.
- ❖ Njohja me vlerat natyrore dhe mjedisore të zonës dhe sipërfaqes.
- ❖ Konsultimi me dokumenta ligjorë e administrativë dhe raporte të VNM-së për veprimtari të njëjta.
- ❖ Vlerësimi i rëndësisë së ndikimeve të identifikuar.

Ndikimet kryesore ne mjedis nga ndertimi dhe funksionimi i ketij aktiviteti konsistojne ne vija te pergjithshme si me poshte:

- ❖ Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- ❖ Shkarkimet ne uje
- ❖ Ndikimi ne toke
- ❖ Ndikimi ne flore/faune
- ❖ Mbetjet e prodhuara
- ❖ Ndikime social-ekonomike
- ❖ Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- ❖ Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- ❖ Ndikim ne peizazhin e zones
- ❖ Ndikim ne ndryshimet klimatike

Aktivitetet që do të japin ndikime të mundshme negativisht në mjedisi gjatë të gjitha fazave të zbatimit të projektit, asaj parapregatitore, të ndertimit të objektit e të venies në funksion janë veprimtaritë si:

- Gërmimet e tokës dhe pastrimi i bimësisë së tërrenit ku do të ndertohet objekti
- Kampi i ndërtimit, duke përfshirë magazinimet dhe parkimin e mjeteve;
- Ndërtimi i themeleve për instalimin e pajisjeve
- Ndërtimi i rrugëve të mundshme e të përkohshme ose që do të mbesin.

Keto veprimtari mund të ndikojë në mjedisin biofizik dhe social –ekonomik nga:

- Zenia e përkohëshme ose e përherëshme e tokës;
- Përdorimi i makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit;
- Përdorimi i materialeve të ndërtimit;
- Përdorimi i karburantit gjatë ndërtimit;

VNM- PARAPRAKE

- Gjenerimi i emisioneve në ajër;
- Gjenerimi i zhurmave;
- Trajtimi dhe depozitimi i mbetjeve të prodhuara.

Ndikimi i karakteristikave aktuale klimatike mbi aktivitetet e projektit

Vendi ku zbatohet projekti, qytetiin e Divjakes karakterizohet nga klimë mesdhetare fushore ne nenazonen qendrore. Megjithate, relievi fushor dhe afersia me detin bejne qe te formohet mikroklima kryesisht me dimer te bute dhe vere te nxehte.

ç) Një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve.

Nje pershkrim i shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis:

1. Shkarkimet ne mjedis nga zbatimi i ketij projekti, ne terma te shkurtuara do te ishte: Shkarkime ne ajer nga aktiviteti ndertimor. Pluhurat fluturues te kantierit te ndertimit, gazet e mjeteve te punes dhe te transportit.
2. Shkarkime ne ujera nga ujerat e shiut nga kantieri dhe gjate shfrytezimit te sistemimit te argjinatures.
3. Shkarkimet e mbetjeve te ngurta, mbetjet urbane nga aktiviteti human dhe dheu qe do te largohet nga siperfaqja qe do te ndertoht.
4. Zhurmat e punimeve ndertimore, nga mjetet e renda, nga transporti, por edhe gjate funksionimit te argjinatures te mbrojtjes se lagunes

Emetimet ne ajer

Emetimet ne ajer vijne nga perhapja e pluhurave te materialeve te ndertimit dhe materialit te germuar te siperfaqes se tokes. Gjithashtu djegia e lendes djegese, qe shkaktohet nga automjetet qe frekuentojne kete ambient.

Nga punimet ndertuese do te kete perhapje te pluhurave nga qarkullimi i mjeteve.

Perdorimi i reres, zhavorrit, proceset e betonimit dhe shtrimit te siperfaqeve perreth, si dhe nga transporti i automjeteve te dheut te germuar apo te mbetjeve inerte te prodhuara gjate ndertimit. Keto mjete duhet te plotesojne patjeter kushtet teknike te qarkullimit rrugor, te mos ngarkohen me shume se kapaciteti i projektuar, te mbulohet karrocERIA me mushama te posacme, si dhe te lahen rregullisht kur dalin nga kantieri i ndertimit dhe nga kantieri i prodhimit te betonit, te inerteve apo ne sheshin e depozitimit te dheut te germuar.

Vete zhvillimi i ketij aktiviteti eshte ndertim i "Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I ne nje zone rurale jo te banuar ku cilesia e ajrit eshte e larte dhe subjekti eshte i detyruar te plotesoje kushtet ligjore te mjedisit per mbrojtjen e cilesise se ajerit.

Shkarkime ne uje

Ujerrat qe dalin nga aktiviteti i rikualifikimit te zones jane ujera te cilat lindin si rrjedhoje e aktivitetit te lagies se kantierit, larjes se gomave te automjeteve dhe ujerat e rreshjeve nga kushtet atmosferike. Gjate ndertimit, ne varesi edhe te rreshjeve te shiut, mund te grumbullohet sasi e konsiderueshme e ujerave por duke ditur llojin e terrenit seshte i nevojshem grumbullimi i tyre pasi ato rrjedhin me rrjedhje te lire dhe nuk jane ujera te ndotur, dhe pse pjeserisht ato filtrojne ne nentoke. **Duke qene se "Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I, eshte ne nje zone te ndjeshme mjedisore, dhe ka ndikime te rendesishem ne mjedis subjekti ndertues duhet te tregojë kujdes.**

Zhurmat dhe vibrimet

Gjatë fazës së ndërtimit në zonë priten te regjistrohen nivele relativisht të larta të zhurmes. Nivele të konsiderueshme të zhurmës dhe vibrimeve pritet të shkaktohen kryesisht nga përdorimi i pajisjeve të rënda, duke përfshirë dhe kamionët qe transportojne paisjet dhe materialet e ndertimit per ngritjen e argjinatures mbrojtese gjatë përgatitjes se sheshit dhe veprimtarive të ndërtimit. Shqetësimet që rezultojnë nga zhurmat e ndërtimit nuk mund të përjashtohen duke pasur parasysh se zona e projektit është jo e populluar. Zhurmat qe prodhohen vijne kryesisht nga mjetet rrugore si dhe nga perdorimi i vincave te ndryshem, gjeneratoreve, transformatoreve, zhurma e prodhuar nga vete personat qe do te punojne per ndertimin e ngritjen e argjinatures proceset e hedhjes se betonit, perdorimi i skelave dhe derrasave, pajisjeve te prerjes se hekurit, etj. Punëtorët që mund të ndodhen në mjedise ku niveli i zhurmave e tejkalon limitin mund të perdorin masa mbrojtese per shqisat e degjimit. Kjo duhet te kihet parasysh nga drejtuesi teknik i punimeve. Nuk do te shkaktohen vibrime shqetsuese gjate punimeve.

Per te reduktuar kete ndikim tek zonat e banuara qe ndodhen ne afersi te vendit ku do te zhvillohet projekti, subjekti ndertues, nuk duhet te punoje gjate oreve te vona ku niveli i lejuar i zhurmave eshte me i ulet dhe fonia e rruges apo aktiviteteve te tjera eshte me e ulet.

Nuk do te shkaktohen vibrime shqetesuese per komunitetin perreth, gjate funksionimit te aktivitetit, pasi aktiviteti ne fjale do te ndertohet ne nje distance te konsiderueshme nga shtepite e banuara dhe do te jete ne funksion te aktivitetit duke permiresuar ne kete menyre furnizimin me energji elektrike te zones.

Burimi i ndikimeve

Në përgjithësi, ka tri burime themelore të zhurmës nga nënstacionet. Secili prej tyre ka spektrin e saj karakteristike dhe modelin e shfaqjes për shkak të natyrës së mekanizmave gjeneruese të zhurmës ku përfshihet:

- Zhurma e transformatoreve është përafërsisht konstante me një frekuencë të ulët dhe ndodh në harmoni të frekuencave të furnizimit, të cilat zakonisht janë dominante.

- Ftohesit e gjeneratoreve gjenerojë zhurmë me band të gjere, edhe pse ata nuk janë në veprim të vazhdueshëm;
- Zhurma e shkyqesve është e gjeneruar nga funksionimi i qarkut elektrik dhe ka kohëzgjatje të shkurtër.

Mbetjet e prodhuara

Në këtë fazë, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qënë se shumica e vëllimit të përgjithshëm të aktivitetëve të ndërtimit do të jenë të llojeve të parafabrikuara, sasia e mbetjeve të ndërtimit nuk do të jetë e rëndësishme. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktivitetëve të ndërtimit dhe janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit. Keto mbetje janë të ndryshme, si vegetative, betoni, elektromekanike etj. Nuk pritët krijimi i mbetjeve që vijnë nga mirëmbajtja teknike e makinerive të ndërtimit dhe të automjeteve të tjera pasi ky aktivitet nuk do të kryhet brenda zones së ndërtimit. Për pasojë nuk do të ketë mbetje të tilla si goma të përdorura, bateri, vajra, etj. Mbetjet e ngurta dhe sanitare do të prodhohen nga punëtorët nga konsumi gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje e të ngjashme me mbeturinat shtëpiake.

Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme

Burimet e gjenerimit të mbetjeve të ngurta janë kryesisht nga punimet e tokës për themelet, pastrimit të bimësisë, punimeve me konstruksione metalike, punimet e betonit, të rërës, zhavorrit, mbeturina ushqimore. Mbetje të rrezikshme përfshin vajra, karburante, graso, etj, të cilat mund të rrjedhin nga aktivitetet e ndërtimit dhe operimit nga mjetet. Ndikimi në mjedis gjatë operimit dhe mirëmbajtjes gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së argjinatures, ritmet e prodhimit të mbetjeve të rrezikshme e mbeturinave janë të ulta. Edhe në këte fazë mund të përftohen vajra, karburante, etj të gjeneruara nga transformatorët dhe vajrat e automjeteve të mirëmbajtjes, lëndë djegëse, graso, të cilat janë klasifikuar si mbeturina të rrezikshme; mbetje nga pajisje elektrike që vijnë nga zëvendesimi i pjeseve të konsumuara e të vjetëruara, si dhe ambalazhet e produkteve si nga përdorimi i bojrave etj.

Operatorët që do të bëjnë heqjen dhe transportin e këtyre mbetjeve duhet të jenë të paisur me License III.2.B sipas shtojcës nr.1 të ligjit nr 10448 date 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit” ose në shesh depozitimet e perkoshme të percaktuara nga Bashkia Elbasan në përputhje me VKM 229 date 23.04.2014” Për mënyrën e transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit "**Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit**", **Faza I**, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit të objektit, i cili krijon mbetje.

Sipas VKM Nr.402 date:30.06.2021 Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve mbetjet te cilat parashikohen te krijohen jane :

20 Mbetje urbane (Mbetjet shtepiake dhe tregtare, mbetje industriale e institucionale te ngjashme) perfs hire fraksionet e mbledhura vecmas

20 01 fraksionet e ndara

20 01 01 leter karton

20 01 02 qelq

20 01 08 mbetje te biodegradueshme

20 01 39 plastike

20 02 mbetjet e kopshteve dhe parqeve

20 02 01 mbetje te biodegradueshme

17 09 04 materiale inerte te prodhuara nga punimet si dhe mbetje qe perfs hihen ne kategorine e KODIT 17 05 Dhera (duke perfs hire dhera te germuar nga toka te kontaminuara, gure dhe balta te tjera) dhe nenkategorine e tij:

Kodi 17 05 04: Dhera dhe gure, te tjera nga ato te permendura ne 17 05 03;

Kodi 17 05 08: Çakell,te tjera nga ato te permendura ne 17 05 07;

Kodi 17 09 04: Mbetje te perziera nga ndertimi dhe te prishjeve;

Jemi ne nje zone jo te ndjeshme dhe per cdo ndikim sado te vogel ne mjedis subjekti duhet te zbatoje me rigorozitet kushtet e kesaj zone, dhe pse nuk eshte e ndjeshme, duke marre ne konsiderate dhe parimin “ndotesi paguan”.

c) Informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Analize e përmbledhur e kohezgjatjes se ndikimet negative ne mjedis

Aktivitetet qe do te japin ndikime te mundshme negativisht ne mjedis vetem gjate te fazes se zbatimit te projektit, ku perfs hihet ajo parapregatitore e terrenit dhe te ndertimit te objektit lidhen me veprimtarite si vijon:

- Gërmimet e tokës dhe pastrimi i bimësia së terrenit ku do të ndertohet objekti;
- Kampi i ndertimit, duke perfs hirë magazinimet e parkimin e mjeteve;
- Ndertimi i themeleve për instalimin e pajisjeve e objeteve per argjinaturen;
- Ndertimi i rrugëve të mundshme e të perkohshme ose qe do te mbesin ne afersi te sheshit të ndertimit e brenda tij.

Impaktet e parashikuara, gjate punimeve të ndertimit qe mund të zgjasin rreth 24 muaj nuk do të jenë të rëndësishme për cilësinë e ajrit në zonë.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në biodiversitet

Ndikimet e mundshme mbi burimet ekologjike dhe biodiversitetin gjatë fazës së ndërtimit përfshijnë tjetërsimin e vendit si habitat artificial e gjysem natyror, humbja e fragmentimi i këtij habitati, degradimi i komuniteteve të kafshëve e shqetesimi i tyre ose migrimi i përkohshëm i atyre të zonës buferike shkaktuar nga zhurma, dhe prania e njerëzve dhe makinerive. Po kështu ndotjet nga pluhuri dhe emetimi i substancave të ndotura, rreziku i zjarrit në afërsi të shesheve të ndërtimit, çojnë në degradimin e kushteve të nevojshme për të mbështetur biodiversitetin. Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i kufizuar dhe rezultojnë në një rëndësie pothuajse të papërfillëshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ujërat nëntoksore

Ndikimet e mundshme që do të zgjasin vetëm gjatë fazës ndertimore janë:

- Punimet e ndërtimit, themelet dhe vepra të tjera të lidhura me tokën;
- Aktivizimi i makinerive në ndërtim dhe transport, të cilat mund të sjellin rrezikun e ndotjes nga karburanti dhe vaji. Ndikimet e mundshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë të përkohëshme dhe do të zbuten duke aplikuar praktikat më të mira për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve mbi ujërat sipërfaqësore

Ndikimet e mundshme mbi rrjedhat e ujit të lidhura me fazen parandërtimore dhe veprimtaritë e ndërtimit të ndryshme (ndërtimi i rrugëve hyrëse eventuale, punime tokësore dhe të kullimit; makinerive të ndërtimit dhe mjeteve të transportit; strukturat mbajtese, themelet, etj), përfshijnë: Ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore të cilat janë vlerësuar të jenë të ulët, të një probabiliteti të moderuar dhe me shtrirje vetëm lokale.

Nuk ka asnjë ndikim parashikuar mbetur në ujërat sipërfaqësore e nëntoksore, gjatë fazës së operimit.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në tokë

Ndikimi me kohezgjatje pa limit është humbja e shtresës së puneshme të tokës nga punimet toksore për punimet ndertimore për mbrojtjen e argjinatures. Makinëritë e ndërtimit si dhe makinëritë e renda që bëjnë mbathjen e tokës mund të ndotin zonën me derdhjet e naftës, dhe mund të ngjeshin ose të dëmtojë tokën në zonën buferike. Ky ndikim pavarësisht nga kohezgjatja, efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitet të ulët e me shtrirje lokale duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj. Nuk ka ndikim të pritsëm në përdorimin e tokës gjatë fazës së operimit dhe mirëmbajtjes.

Analize për kohëzgjatjen e ndikimeve në ajër

Ndikimet ne ajer do te zgjasin aq kohe sa do te zgjasin punimet.

Analize per kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga zhurmat dhe vibrimet

Zhurma dhe dridhjet do të gjenerohen kryesisht nga aktivitetet e ndërtimit dhe mjeteve të transportit, të cilat do të jenë në përgjithësi kamionë të rëndë dhe makineri të ndryshme si ekskavatorëve, fadromat, vinça, etj. Reagimi i njerëzve për vibracionet në terren është i ndikuar nga shumë faktorë fizike ku përfshihet dhe kohezgjatja. Është pranuar përgjithësisht se për shumicën e njerëzve, nivelet dridhjeve ndërmjet 0.15 dhe 0.3 mm/s janë vetëm te perceptueshme. Për shkak të faktit se nuk ka shtepi banimi në afersi të nënstacionit, ka shumë pak gjasa që dridhjet nga ndërtimit të propozuar të jetë i dukshëm.

Analize per kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme ne peisazh dhe vizualiteti

Subjekti qe do te kryeje punimet duhet te jete shume I kujdesshem qe mos te kete ndikime ne peisazh dhe vizualitet..

Analize per kohezgjatjen e ndikimeve të mundshme nga gjenerimi i mbetjeve

Në fazen ndertimore, burimi kryesor i mbetjeve do të jetë aktiviteti ndërtimor, dhe mbetjet e krijuara nga punëtorët. Duke qënë se shumica e vëllimit të përgjithshëm të aktiviteteve të ndërtimit do të jenë të llojeve të parafabrikuara, sasia e mbetjeve të ndërtimit nuk do të jetë e rëndësishme. Fraksionet e mbetjeve që do të krijohen si rezultat i aktiviteteve të ndërtimit janë në lidhje me llojet e materialeve dhe pajisjeve që do të përdoren gjatë kryerjes së fazave të ndërtimit. Mbetjet e ngurta dhe sanitare qe do të prodhohen nga punëtorët gjatë qëndrimit të tyre në vendet e ndërtimit. Mbetjet e ngurta janë mbeturinat komunale me të njëjtën përbërje të ngjashme me mbeturinat shtepiake. Gjatë funksionimit e mirëmbajtjes së nestacionit ritmet e prodhimit të mbetjeve do te jenë të ulta.

dh) Të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Bazuar në karakteristikat dhe elementet e projektit, distanca e ndikimit në mjedis mund të shtrihet vetëm në një zonë periferike bufer, por përgjithësisht nuk mund të jetë jashtë hapësirës së territorit ku shtrihet ndertimi i objektit veçanërisht gjatë fazës së operimit. Për shkak të faktit se nuk ka prona banimi në afersi nga vendi për zgjerimin e nënstacionit, ka shumë pak gjasa që dridhjet nga

ndërtimi i nestacionit të propozuar të jetë i dukshëm. Të vetmet burime të vibrimit që merret në konsideratë do të jenë kamionët e tonazhit të rëndë gjatë udhëtimit përgjatë rrugëve sekondare.

Për aktivitetet e ndërtimit distanca nga ku mund të përceptohet vibrimi është si vijon:

Ndikimi ne mjedisin e zones do te kete efektet e tij ne nje distance jo shume te gjere, me dhjetra ose qindra metra, pra ne nje distance jo me te larget se 200-300 m. Ky ndikim do te jete i perkohshem dhe nuk eshte me veti akumuluese ne mjedis. Nuk shkarkohen elemente te demshem per mjedisin, si ne ate uhor, per ajrin, token dhe per biodiversitetin. Ndikimi ne peizazh do te jete i perkohshem per fazen e ndertimit dhe i perhershem nga sistemimi i argjinatures.

Nga analiza e bere te gjithe faktoreve me ndikim ne mjedis, rezulton se nga aktiviteti i ndertimit ndikimet do te kete nje shtrirje te vogel te mundeshme hapsinore, por do te jene te kufizuara brenda sheshit te ndertimit, pra brenda zones qe zhvillohet.

d) Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis u orientua nga rëndësia e aktivitetit, vendi ku ai ndodhet, pasuritë natyrore dhe humane të zonës si dhe vlerat e veçanta të tyre në identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutëse duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike të investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes së projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative është ndërthurur edhe me ndikime të rëndësishme pozitive sidomos në kompensime indirekte mbi komunitetin.

Subjekti investitor, ne kete rast FSHZH, duhet qe pas perfundimit te ndertimit te objektit dhe infrastruktures perkatese, te kryeje rehabilitimin e plote te siperfaqeve te lira, si ato te shtruara me beton, per rruget hyrese, sheshet dhe per siperfaqet e gjelberta.

Sistemimi i sheshi të instalimit të nënstacionit është ngushtësisht i varur nga kërkesat teknike inxhinierike të nënstacionit, distancat e sigurisë, efektiviteti i përdorimit racional të tokës në vartësi të parametrave teknik të projektit. Nderhyrjet rehabilituese brenda sheshit lidhen ngusht me respektimin e kushteve teknike inxhinierike të projektit. Shtresezimet e sipërfaqeve të sheshit midis elementeve koridoret qarkulluese e të shërbimeve të mirembajtjes respektojnë rigorozisht kushtet teknike. Zona periferike duhet të sistemohet e restaurohet duke ju referuar praktikave më të mira restauruese e rehabilituese në tëresi që risjellin e promovojnë vlerat e pejsazhit si dhe cilësitë e habitateve në përgjithësi. Në këtë mënyrë ndikohen në rritje të përfomancës mjedisore dhe në përmirsimin e cilësisë së ajrit, mbrojtjen nga erozioni, ndikime pozitive në mikroklimat etj.

Gjelberimi i zonës, kryhet me bimesi autoktone, të përshtatshme dhe me kërkesat e cilsive të tokës, por në këtë mënyrë mbi të gjitha që plotësojnë kërkesat restauruese estetike dhe ekologjike. Llojet pyjore që përdoren për pyllzimin e sipërfaqes për rreth objektit ndikojnë në rehabilitimin e terrenit duke e kthyer në një sipërfaqe të qëndrueshme e jo ndotese. Zona do të mbrohet në këtë mënyrë nga erozioni dhe përmirsohen ekuilibrat natyror që lidhen me ushqimin e ujërave sipërfaqesore e nëntokësore në rastet e reshjeve.

Punimet e pastrimit e sistemimit të vendit pas përfundimit të instalimeve përfundimit të objektit ndertimor përfshijnë:

- Largimi i të gjitha pajisjeve e mjeteve që kanë shërbyer gjatë procesit ndertimor e instalimeve në objekt.
- Largimi dhe administrimi i përshtatshëm i të gjitha mbetjeve inerte nga teritori që rehabilitohet dhe çdo lloje mbetje tjetër në qofte se nuk është trajtuar apo neglizhuar.
- Ndalimi i çdo veprimtarive që ka të beje direkt ose indirekt me aktivitetet ndertimore.
- Marrja e masave në pengimin e qarkullimit të lirë të njerezve e kafshëve deri në rahabilitimin e plotë të zonës. Pergatitja e tokës për rehabilitim me anë të gjelberimit ka të beje dhe me rivlerësimin e shtresave të saj nga pikpamja e strukturës së aftësisë për tu riveshur me mbulesa vegjetative.

Në kete kuptim mund të bëhen përgatitje shtesë duke sjelle material më të pasur me lënde ushqyese si ai torfik etj. Eshtë shumë e rëndesishme që në kuadrin e rimodelimit të tokës të rishikohet e vleresohet forma e rilievit për ta harmonizuar në mënyrë sa më të plotë me rilievin egzistues të zonës.

Veshja me bimesi e territoreve të ndikuara është ndikim me potencial në krijimin e një ekulibri të stabilizuar natyror me funksion të shumfishtë ripertritës e me ndikime direkte në përmirsimin e treguesve mjedisor. Ndikimi me përfitues është mbrojtja nga erozioni, rikrijimi i habitateve duke synuar ngjashmeritë me ato natyroret. Ndikim të rëndesishem ka në përmirsimin e vlerave pejsazhiste, duke minimizuar aspaktin pamor te nderhyrjes nga projekti.

Mundesia e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe kthimi i mjedisit ne gjendjen e meparshme. Pas perfundimit te punimeve ndertimore, do te behet pastrimi dhe largimi i mbetjeve qe mund te kene ngelur, gjelberimi qe eshte pjese e projektit, por nuk mund te pretendojme rikthim ne gjendjen e mepareshme pasi ne te do te jete "Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I".

Kostot financiare te peraferta per rehabilitim

Masat kryesore për zbutjen e ndikimeve negative në të gjitha fazat e zbatimit të projektit janë të perfshira ne kostot e ndertimit **"Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I"**. Masat e identifikuar ju referohen praktikave më të mira rehabilituese si pjesë e planit të menaxhimit mjedisor në tëresi ku kostot e vleresuara përfshihen në kostot e zbatimit të projektit.

ë) Masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis.

Ne menyre te pergjithshme do te japim disa prej masave qe duhet te zbatohen nga investitori dhe nenkontratesit per zbatimin e projektit. Disa prej masave kryesore qe do te ndermerren jane permendur ne menyre te permbledhur si me poshte:

Masat lehtesuese qe do te ndermerren gjate ndertimit dhe funksionimit te objektit.

Vleresimi i ndikimit ne mjedis duhet te ndikojë ne dhenien e zgjidhjeve per shmangie te ndotjes dhe mbrojtjes se mjedisit. Mbrojtja e mjedisit perben ne vetvete nje sere masash zbutese, parandaluese. Ne menyre te pergjitheshme do te japim disa prej masave qe do te ndermerren nga investitori per ngritjen e argjinatures. Në fazën fillestare të punimeve, do të kryhet punë përgatitore për pastrimin e vendit dhe përgatitje për fillimin e punimeve.

Masat që duhet të adoptohen për të minimizuar pluhurin gjatë ndërtimit përfshijnë:

- ❖ Mbylljen ose rrethimin e vendeve të ndërtimit.
- ❖ Shpërndarjen e ujit në rrugët e pluhurosura.
- ❖ Ruajtjen e përmbajtjes së ujit në materialet e ndërtimit.
- ❖ Të gjitha automjetet dhe makineritë e ndërtimit duhet të veprojnë në përputhje me standardet relevante për automjetet dhe të kenë mirëmbajtjen e duhur për të minimizuar ndotjen e ajrit.
- ❖ Përdorimi i mbulesave nga automjetet e transportit, kontrolli i shpejtësisë së automjeteve, si dhe zgjedhja e rrugëve të transportit për të minimizuar ndikimin nga pluhuri.
- ❖ Minimizimi i kohës së qëndrimit në vend-ruajtje apo magazinim të materialeve të ndërtimit.
- ❖ Sigurimi i pajisjeve personale mbrojtëse për punëtorët për të minimizuar rrezikun nga pluhuri dhe të tjera substancave ndotëse.

Masat kryesore për ruajtjen e flores/faunes.

Ndikimet negative të shkaktuara në biodiversitet nga pluhurat dhe zhurmat kanë vetëm rrugë reduktimi siç është përcaktuar në uljen e niveleve të tyre për ajrin dhe ujin. Përsa i përket humbjes së biomasës në territorin që do të shfrytëzohet, habitateve të fragmentizuara do të merren masat si gjelbërimi përreth territorit të objektit, që do të rrisë sipërfaqet e gjelbëruara, gjë e cila garanton diellzimin e nevojshëm dhe nxitjen e zhvillimit të specieve të tjera spontane. Në këtë mënyrë mund të sigurohet një vazhdimësi natyrore e vegjetacionit në zonat përreth:

- ❖ Te mos priten peme nese seshte e nevojshme.
- ❖ Te mos demtohet fauna e zones duke e mbrojtur ate kur eshte ne rrezik.

Masat kryesore per zvogëlimin e zhurmave do të përfshijnë:

- ❖ Asnjë punim ndërtimi gjatë natës me makineri të rënda, nga ora 22:00 në oren 6:00 afër zonave të banuara, ndonese objekti ndodhet larg qendrave te banuara.
- ❖ Mirëmbajtje dhe funksionimin e duhur të makinerive të ndërtimit për të minimizuar burimin e zhurmës.

Masat kryesore per trajtimin e ujerave:

Është e nevojshme marrja e masave të përgjithshme të praktikës së mirë ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat nëntokësore, gjatë përgatitjes dhe fazat e ndërtimit. Shmangia sa më shumë që te jetë e mundur zonat ku ringarkohet akuiferi. Nëse merren këto masa zbutëse, ndikimet e mundshme mund të reduktohet në një probabilitet të ulët dhe rëndësisë vetëm lokale. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme duhet të zbutet duke aplikuar praktikatat më të miran për zbutjen nga këto lloje të mbeturinave.

Eshtë i nevojshem zbatimi i një sërë masash të përgjithshme të praktikës së mirë të ndërtimit për zvogëlimin e ndikimeve të mundshme të shkarkimeve në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit të nënstacionit.

Masat zbutëse përfshijnë:

- Shmangia e aktiviteteve që lidhen me ndertimin në afersi e ngjitur me shtratin e lumit të Shkumbinit, për të zvogëluar mundësinë e erozionit të tokës;
- Ndalimi i përdorimit të mjeteve të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes në ujrata;
- Duhet të merren masa zbutëse që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga ujërat e zeza dhe nga mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme.

Në qoftë se janë marrë masat e mësipërme zbutëse, ndikimet e mundshme negative në ujërat sipërfaqësore mund të reduktohet në një rëndësi të papërfillshme, dhe në masë lokale.

Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonen e projektit të nënstacionit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitet e madhësi të ulët më shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikatat e duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.

Në vijim paraqitet një listë kontrolli për Masat Zbutëse të këtij projekti :

Komponentët Mjedisorë	Efektet e Mundshme	Masat Zbutëse
1 Mjedi Fizik Dherat	-Dëmtime të strukturës së dheut si pasojë e hedhjes së materialeve, trafikut të transportit, etj. - Humbja e pjeseshme e dheut sipërfaqësor gjatë gërmimeve - Efektet e gërmimeve, hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	-Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore, shmangia e punimeve në zonat e ndjeshme gjatë kushteve me negativitet të lartë, sigurimi i rrugëve për turistet, sipas nevojës, riparimi i zonave të dëmtuara -Heqja e dheut sipërfaqësor aty ku është e nevojshme, ruajtja dhe rivendosja mbas mbarimit të ndërtimeve -Projektimi i drenazheve dhe mjeteve të tjera të hedhjes së mbeturinave për të siguruar stabilitetin e dheut sipërfaqësor
Toka	-Efektet e gërmimeve / hedhja e dheut dhe materialeve të tjera	Mbrojtja e zonave jo-ndërtimore -Kryerja e punimeve në mënyrë të tillë që të minimizohet sipërfaqja e ndikuar e tokës -Perdorimi i rrugëve ekzistuese si rrugë hyrese në sektorin e punimeve -Transportimi/hedhja e materialeve në vende të aprovuara
Cilësia e Ajrit	-Pluhuri dhe tymrat gjatë ndërtimit -Efektet nga funksionimi I argjinatures	-Të kontrollohet pluhuri me ujë, të kontrollohen metodat e ndërtimit, afatet e punimeve, shpejtësia e automjeteve -Mbulimi i kamioneve të transportit
Mjedi Akustik	-Zhurma nga punimet ndërtimore,	-Të përcaktohen afatë të punimeve për të minimizuar shqetësimet -Të përdoren metoda dhe pajisje -Sigurimi i paisjeve personale mbrojtëse për punëtorët
Mjedisibijologjik		
Habitatet Natyrore	-Shqetësimi i habitateve natyrore nga ndërtimi p.sh. pluhuri, zhurma, hedhje e mbeturinave të patrajtuara, etj.	-Përzgjedhja me kujdes e pikave të hedhjes së mbeturinave dhe metodave të perpunimit -Mbrojtja e zonave të ndjeshme brenda/afër argjinatures
Fauna dhe Flora	-Humbja ose degradimi mbas ndërtimeve, ndryshimet në regjimet mjedisore, etj	-Përzgjedhja e metodave të përshtatshme ndërtimore -Mbrojtja e zonave të ndjeshme mjedisore brenda/afër kampingut

<i>Mjedisi Social</i>		
Estetika dhe Terreni	-Efekte lokale vizuale mbas përfundimit të punimeve dhe disa ndryshime në terrenin e përgjithshëm natyror dhe të krijuar, humbje bimësie, etj. -Zhurma, pluhur, mbeturina, etj. gjatë dhe mbas fazës ndërtimore	- Rigjellërim i zonave të punimeve. -Kryerje me kujdes e mbylljes së pikave të punimeve dhe hedhjes së mbeturinave -Sistemimi i territorit sipas projektit të zbatimit.
Shëndeti i Njerëzve	-Rreziqe për shëndetin dhe sigurinë gjatë dhe mbas fazës ndërtimore -Efekte mbi shëndetin dhe sëmundje nga mbeturinat e, ujrave e ndotur, rreziqet nga zjarri etj.	-Të zgjidhen kontraktorë me eksperiencë, të përshihen masa sigurie dhe kërkesat mjedisore në dokumentat e kontratës. -Të sigurohet informacion mbi masat zbutëse. Krijimi i kapaciteteve të theksojë nëvojën për punime më siguri, mbikqyrje të mirë, planifikim dhe parashikim të kujdesshëm të punimeve, -Projektim i sakte dhe i përshatshëm për masat e sigurisë të operimit dhe mirëmbajtjes, procedurat e sigurisë, etj. -Hedhje e kujdesshme e mbeturinave

e) Ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Ky projekt nuk prek zonat kufitare dhe si rrjedhojë edhe ndikimi i tij nuk shkakton demtim të mjedisit ndërkufitar.

Projekti nuk ndikon cenimin e sigurisë së jetës dhe shëndetit as të shteteve fqinje, as të qendrave të banuara të rajonit.

Nuk ndikohen burimet ujore ndërkufitare, nuk ndikohet cilesia e ajrit në kontekstin ndërkufitar.

Për këtë kapitull, nuk kryhen vlerësime dhe analiza të detajuara për shkak të vendodhjes së projektit në brendësi të kufirit shtetëror dhe distancës që ai ruan me kufirin dhe shtetet fqinje.

➤ PERFUNDIME

Në kuadrin e zbatimit të këtij projekti, veprimtaritë që do të japin ndikime të mundshme negative në mjedis gjatë të gjitha fazave të këtij procesi, asaj parapregatitore, të ndërtimit të objektit e të venies në funksion janë veprimtaritë ndërtimore të cilat mund të ndikojnë në mjedisin biofizik dhe social – ekonomik. Për këto ndikime ky raport i VNM-së ka specifikuar masa konkrete zbutëse të ndikimeve. Në këtë raport janë parashtruar gjithashtu në mënyrë të detajuar dhe kërkesat mjedisore dhe sociale të fazës së venies në funksion dhe të mirëmbajtjes. Nga vlerësimi i ndikimit në mjedis të ndërtimit të argjinatures arrihet në këto përfundime:

- Ndikimet negative në biodiversitet gjatë fazës së ndërtimit do të jetë i kufizuar dhe rezultojnë të një rëndësie pothuajse të papërfillshme, me zbatimin e masave dhe procedurave të duhura parandaluese. Nuk ka ndikim flora dhe fauna në përgjithësi, dhe në speciet endemike, të rralla ose të rrezikuara në veçanti, gjatë fazës së operimit.
- Nuk janë parashikuar ndikime të rëndësishme, në ujërat sipërfaqësore, gjatë fazës së ndërtimit, për zonen e projektit të nënstacionit. Ndikimet e përkohshme nga ujërat e zeza dhe mbeturinave të ngurta dhe të rrezikshme janë vlerësuar nga probabilitetet e madhësisë të ulët me shtrirje lokale. Ato mund të zbutet duke zbatuar praktikatat e duhura për këto lloje të mbeturinave. Pasi zbatohen këto masa zbutëse, ndikimi i pritshëm mund të vlerësohet si i parëndësishëm.
- Ndikimet e mundshme negative në ujërat nëntokësore nga ujërat e zeza dhe mbetjeve të ngurta dhe të rrezikshme mund të vlerësohen në probabilitetet të ulët, dhe me shtrirje lokale gjatë fazës së ndërtimit.
- Efektet e mundshme negative mbi cilësinë e tokës janë vlerësuar me probabilitetet të ulët duke mos marrë parasysh tjetërsimin e përdorimit të saj si dhe me shtrirje lokale. Zbutja mund të bëhet përmes planifikimit për përdorimin e rrugëve ekzistuese hyrëse; Rehabilitimi i terrenit pas punimeve të ndërtimit nga ngjeshjet e krijuara.
- Per tektoninë e sizmicitetin, do të jetë e nevojshme zbatimi i praktikave më të mira të përcaktuara në fazën e projektimit gjatë ndërtimit të komponentëve të projektit të propozuar.
- Aktivitetet e projektit duhet të marrin në konsideratë parametrat gjeologjike dhe kategorinë e tokës për të shmangur ndonjë ndikim eventual negativ të tilla si lëngëzimi e tokës, rrëshqitje, erozionit sedimentimit etj. Keto ndikime vlerësohet me probabilitetet të ulët, me madhësi e shtrirjen lokale. Ato mund të zbuten duke shmangur rrëshqitje të tokës shkaktuara nga punimet e ndërtimit. Me marrjen e masave zbutëse të përmendura më sipër, ndikimet e mundshme do të vlerësohen të papërfillshme.
- Ndikimi, i aktiviteteve të projektit në cilësinë e ajrit gjatë fazës së ndërtimit, është i përkohshëm, i kthyeshëm, dhe i lokalizuar në vendin e punës. Ky ndikim ndikon në mjedisin lokal në afërsi të objektit të nënstacionit dhe mund të zbutet duke marrë masat e duhura. Nuk ka asnjë ndikim të rëndësishëm parashikuar nga projekti në cilësinë e ajrit gjatë fazës operacionale.
- Ndikimet negative nga zhurmat dhe dridhjet e krijuara gjatë fazës së ndërtimit janë të përkohshme dhe të lokalizuara në vend të punës dhe të rrugëve të transportit. Ato janë vlerësuar të jenë të pranueshme me amplitude të vogla dhe mund të zbuten me marrjen e masave të përshtatshme të propozuara.
- Gjatë fazës parapregatitore të terrenit, atë të ndërtimit si dhe venies në funksion ndikimi vlerësohet me probabilitetet të ulët e të moderuar në madhësinë dhe shtrirjen lokale të vepres se argjinatures. Ndikimi mund të zbutet pjesërisht nëse zbatohen masat e duhura zbutëse.
- Në këto zonë ndikimi i mundshëm nga përmblytjet mund të vlerësohet i ulët, me probabilitetet të moderuar, e madhësi të vogël. Nëse merren masat e duhura zbutëse, këto ndikime mund të reduktohen në një probabilitet të ulët.

- Ndertimi i objektit "Sistemimi Dhe Mbrojtja E Argjinatures Veriore Te Lagunes Se Karavastase Prej Erozionit", Faza I” .
- Nuk ka asnjë ndikim të parashikuar të përmbytjeve gjatë fazës së operimit. Ndikimin e mundshëm të ngjarjeve të përmbytjeve, veçanërisht marrja parasysh e ndikimeve nga efektet nga ndryshimet klimatike zbuten nga marrja e masave të parashikuara.
- Mbetjet e ngurta dhe të rrezikshme nga aktivitetet e ndërtimit mund të zbutet. Ndikimi i tyre është i përkohshëm, nëse veprimet e nevojshme të rehabilitimit janë marrë.
- Nuk ka asnjë ndikim negative të parashikuar për banorët përreth nga zhurma e gjeneruar nga ndertimi I argjinatures mbrojtese.
- Persa I perket llojit faunistik ndikimi do te jete I paperfillshem.

Ne Raportin e Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis është parashikuar zbatimi i projektit duke pasur parasysh te gjitha kushtet per mbrojtjen e mjedisit, bazuar ne të gjithë kuadrin ligjor mjedisor shqiptar. Ky raport kontrollohet nga organet shtetërore kompetente. Zhvillimi i ketij aktiviteti nuk shoqerohet me ndikime potenciale ne mjedis por jep nje kontribut mjaft te dukshem ne rritjen e kapacitetit transmetues të energjisë në Shqipëri. Masat për mbrojtjen e mjedisit të parashtruara në ketë raport jane te plota per minimizimin e ndikimeve ne mjedis.

Çertifikata dhe licensa perkatese nga QKB, te specialistit qe ka hartuar raportin e VNM.

Ky raport u hartua nga Studio Mjedisore e licensuar nga Ministria e Mjedisit.

Bashkangjitur materialit nenshkrimi, vula dhe liçensat perkatese.

Hartoi raportin e VNM:

B.O.E. “TAULANT” sh.p.k. & “ABKONS” sh.p.k.

Përgatiti:

Msc.Ing.Mjedis Erjona Qatipi